

## **KODI PENAL**

### **Neni 697 Zotërim i armëve pa leje**

Kushdo që zotëron armë ose municione pa njoftuar organet kompetente, kur njoftimi kërkohet, dënohet me burgim deri në dymbëdhjetë muaj ose me gjobë deri në 371 euro. Kushdo që mbasi ka marrë lajmin se në vendin ku banon ai ndodhen armë ose municione, nuk njofton organin kompetent, dënohet me burgim deri në dy muaj ose me gjobë deri në 258 euro.

### **Neni 698 Mosdorëzim i armëve**

Kushdo që shkel urdhrin, të dhënë ligjërisht nga organet kompetente, për të dorëzuar në afatet e përcaktuara armët ose municionet e mbajtura prej tij, dënohet me burgim jo më të vogël se nëntë muaj ose me gjobë jo më të ulët se 123 euro.

### **Neni 699 Mbajtje e armëve pa leje**

Kushdo që, pa lejen e Organit kompetent shtetëror, kur kërkohet leja mban një armë jashtë banesës së tij ose shtojcave të saj, dënohet me burgim deri në dymbëdhjetë muaj. I nënshtrohet burgimit nga tetëmbëdhjetë muaj deri në tre vjet ai që, jashtë banesës së tij ose të shtojcave të saj, mban një armë për të cilën nuk është dhënë leja. Nëse ndonjë nga veprimet e parashikuara në dispozitat e mësipërme është kryer në një vend ku ka grumbullim ose mbledhje personash, ose natën në një vend të banuar, dënimet shtohen.

### **Neni 700 Rrethana rënduese**

Në rastet e parashikuara nga nenet e mësipërme, dënimi shtohet nëse është e pranishme njëra nga rrethanat e treguara në nenin 680.

### **Neni 701 Masa e sigurisë**

I dënuari për ndonjë nga disa kundërvajtjet e parashikuara nga nenet e mësipërme mund t'i nënshtrohet lirimit nën mbikëqyrjen e policisë.

**Neni 702**  
**Mos ruajtja e armëve. <sup>(1)</sup>**

(...)

(1) Neni që shprehet se: “Dënohet me gjobë deri në dyqind mijë lireta kushdo që, edhe pse i pajisur me leje për mbajtje armësh:

1) dorëzon ose i lë të mbajë një armë personit në moshë më të vogël se katërmbëdhjetë vjeç, ose cilitdo person të paaftë ose jo ekspert në administrimin e saj;

2) gjatë ruajtjes së armëve lë pas dore përdorimin e masave të nevojshme për të penguar që ndonjë nga personat e treguar në numrin e mëparshëm të arrijë t’i përvetësojë lehtësisht ato.

3) mban një pushkë të mbushur në një vend ku ka grumbullim ose mbledhje personash.”  
është shfuqizuar nga neni 9, paragrafi 2, D. L. 13 maj 1991, n. 152.

**Neni 703**  
**Ndezje dhe shpërthime të rrezikshme.**

Kushdo që, pa lejen e organeve kompetente, në një vend të banuar ose në afërsi të tij, ose gjatë një rruge publike ose në drejtim të saj bën qitje me armë zjarri, ndez fishekzjarrë, ose lëshon raketa, ose ngre aerostate me flakë, ose, në përgjithësi, bën ndezje ose shpërthime të rrezikshme, dënohet me gjobë deri në 103 euro.

Nëse veprimi është kryer në një vend ku ka mbledhje ose grumbullim njerëzish, dënimi është burgimi deri në një muaj.

---

**Sistemi Ligje Italiane**

---

L. 2-10-1967 n. 895  
Dispozita për kontrollin e armëve.  
Publikuar në Gazetën Zyrtare në 12 tetor 1967, nr. 255.

**Mbishkrim**

1.

2.

2 – bis

3.

4.

5.

6.

7.

8.

9.

---

**L. 2 tetor 1967, n. 895** <sup>(1)</sup>.

(koment jurisprudence)

**Dispozita për kontrollin e armëve** <sup>(2)</sup> <sup>(3)</sup>.

---

(1) Publikuar në Gazetën Zyrtare në 12 tetor 1967, n. 255.

(2) Paragrafi 1 i nenit 1, D. Lgs. 1 dhjetor 2009, n. 179, në dispozitë të kombinuar me bashkëlidhur 1 të të njëjti dekret, ka konsideruar të domosdoshme qëndrimin në fuqi të kësaj mase.

(3) Shiko, edhe, gjermën g) të paragrafit 1 të nenit 4, D. Lgs. 6 shtator 2011, n. 159.

---

*(koment jurisprudence)*

1. Kushdo që pa lejen e organit kompetent fabrikon ose fut në territorin e Shtetit ose nxjerr në shitje ose jep me çfarëdolloj cilësie armë luftarake ose armë të ngjashme me ato luftarake, ose pjesë të tyre, në gjendje për përdorim, municione luftarake, eksplozivë të çdo lloji, armë kimike ose aparate të tjera vdekjeprurëse, ose i mbledh ato, dënohet me burg nga tre deri në dymbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga 10.000 euro deri në 50.000 euro <sup>(4)</sup> <sup>(5)</sup> <sup>(6)</sup>.

---

(4) Masa e gjobës është rritur në këtë mënyrë nga neni 113, paragrafi katër, L. 24 nëntorit 1981, n. 689. Sanksioni përjashtohet nga depenalizimi në bazë të nenit 32, paragrafi dytë, të ligjit të përmendur L. i 24 nëntorit 1981, n. 689.

(5) Paragraf i modifikuar kështu nga gërma a) e paragrafit 1 të nenit 4, D.Lgs. 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(6) Nen i zëvendësuar kështu nga neni 9, L. 14 tetorit 1974, n. 497. Shiko, edhe, gërmën g) të paragrafit 1 të nenit 4, D. Lgs. i 6 shtatorit 2011, n. 159.

---

*(koment jurisprudence)*

2. Kushdo që mban në çfarëdolloj cilësie në mënyrë të jashtëligjshme armë ose pjesë të tyre, municione, eksplozivë, armë kimike dhe aparate të treguara në nenin e mësipërm dënohet me burgim nga një deri në tetë vjet dhe me gjobë nga 3.000 euro deri në 20.000 euro <sup>(7)</sup> <sup>(8)</sup> <sup>(9)</sup> <sup>(10)</sup>.

---

(7) Masa e gjobës është rritur kështu nga neni 113, paragrafi katër, L. i 24 nëntorit 1981, n. 689. Sanksioni përjashtohet nga depenalizimi në bazë të nenit 32, paragrafi dytë, i ligjit të cituar L. i 24 nëntorit 1981, n. 689.

(8) Nen fillimisht i zëvendësuar nga neni 10, L. i 14 tetorit 1974, n. 497 e më pas i modifikuar kështu nga gërma b) e paragrafit 1 të nenit 4, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(9) Nen i zëvendësuar kështu nga neni 10, L. 14 tetorit 1974, n. 497. Shiko, edhe, gërmën g) të paragrafit 1 të nenit 4, D. Lgs. i 6 shtatorit 2011, n. 159.

(10) Gjykata Kushtetuese, me urdhrin e 11-18 marsit 1999, nr. 73 (Gazeta Zyrtare e 24 marsit 1999, n. 12, Seria speciale), ka deklaruar pathemelësinë e qartë të çështjes së legjitimitetit kushtetues të neneve 2 e 7, të ngritur në lidhje me nenin 3 të Kushtetutës.

---

**2 – bis.** 1. Kushdo që jashtë rasteve të lejuara nga dispozitat ligjore ose nga rregullorja stërvit ndonjë ose jep udhëzime në çfarëdolloj forme, edhe anonime, ose në rrugë telematike për përgatitjen ose për përdorimin e materialeve eksplozivë, të armëve kimike ose të substancave bakteriologjike të dëmshme ose të rrezikshme dhe të aparateve të tjera vdekjeprurëse dënohet, me përjashtim të rastit nëse veprimi përbën një vepër penale më të rëndë, me burgim nga një deri në gjashtë vjet <sup>(11)</sup>.

---

(11) Nen i shtuar nga neni 8, D. L. i 27 korrikut 2005, n. 144, siç është modifikuar nga ligji përkatës i konvertimit.

---

3. Kushdo që shkel urdhrin, e dhënë ligjërisht nga organi kompetent, që të dorëzojë në kufijtë e caktuar armët ose pjesë të tyre, municionet, eksplozivët, armët kimike dhe aparatet e treguara në nenin 1, të mbajtura nga ai në mënyrë të paligjshme deri në momentin e dhënies së urdhrit, dënohet me burg nga një deri në tetë vjet dhe me gjobë nga 3.000 euro deri në 20.000 euro <sup>(12)</sup>.

---

(12) Nen fillimisht i zëvendësuar nga neni 11, L. i 14 tetorit 1974, n. 497 e më pas i modifikuar kështu nga gërma c) e paragrafit 1 të nenit 4, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010. Shiko, edhe, gërmën g) të paragrafit 1 të nenit 4, D. Lgs. i 6 shtatorit 2011, n. 159.

---

*(koment jurisprudence)*

**4.** Kushdo që në mënyrë të paligjshme sjell në vend publik ose të hapur për publikun armë ose pjesë të tyre, municione, eksplozivë, armë kimike dhe aparatet e treguara në nenin 1, dënohet me burg nga dy deri në dhjetë vjet ose me gjobë nga 4.000 euro deri në 40.000 euro <sup>(13)</sup>.

Me përjashtim të rastit kur mbajtja e armës është element përbërës ose rrethanë rënduese specifike për veprën penale të kryer, dënimi i parashikuar nga paragrafi i parë shtohet me një të tretën deri në gjysmën e saj:

- a) kur veprimi është kryer nga persona të maskuar ose nga disa persona së bashku;
- b) kur veprimi është kryer në vendet e parashikuara nga neni 61, numri 11-ter), i kodit penal;
- c) kur veprimi është kryer në afërsi të madhe me institucione kredituese, zyra poste ose sportele automatike të përdorura për marrjen e parave, parqe dhe lulishte publike ose të hapura për publikun, stacione hekurudhore, edhe metropolitane, dhe vende të destinuara për pushimin ose ndalimin e mjeteve të transportit publik <sup>(14)</sup> <sup>(15)</sup>.

(13) Paragraf i modifikuar kështu nga neni 113, paragrafi 4, i L. të 24 nëntorit 1981, n. 689 dhe më pas nga gërma d) e paragrafit 1 të nenit 4, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010. Sanksioni përjashtohet nga depenalizimi në bazë të nenit 32, paragrafi dytë, të ligjit të përmendur L. i 24 nëntorit 1981, n. 689.

(14) Paragraf i zëvendësuar kështu nga paragrafi 30 i nenit 3, L. 15 korrikut 2009, n. 94.

(15) Nen i zëvendësuar kështu nga neni 12, L. i 14 tetorit 1974, n. 497. Shiko, edhe, gërmën g) të paragrafit 1 të nenit 4, D. Lgs. i 6 shtatorit 2011, n. 159.

*(koment jurisprudence)*

**5.** Dënimet e përcaktuara në nenet e mëparshme mund të zvogëlohen në masën që nuk i tejkalon dy të tretat kur për sasinë ose për cilësinë e armëve dhe të pjesëve të tyre, të municioneve, eksplozivëve ose armëve kimike, veprimi duhet të konsiderohet i një rëndësie jo të madhe. Në çdo rast, burgimi nuk mund të jetë më i vogël se gjashtë muaj <sup>(16)</sup>.

(16) ) Paragraf i modifikuar kështu nga gërma e) e paragrafit 1 të nenit 4, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

*(koment jurisprudence)*

**6.** Kushdo që, me qëllimin për të ngjallur frikë publike ose për të nxitur trazira ose rrëmuja publike ose për të cenuar sigurinë publike, bën shpërthimin e armëve të zjarrit

ose bën të pëlcastin bomba ose aparate të tjera ose lëndë shpërthyesë, dënohet, nëse fakti nuk përbën një vepër penale më të rëndë, me burgim nga një deri në tetë vjet <sup>(17)</sup>.

---

(17) Nen i zëvendësuar kështu nga neni 13, L. i 14 tetorit 1974, n. 497. Shiko, edhe, gjermën g) të paragrafit 1 të nenit 4, D. Lgs. i 6 shtatorit 2011, n. 159.

---

*(koment jurisprudence)*

7. Dënimet e përcaktuara përkatësisht në nenet e mëparshëm reduktohen në një të tretën nëse veprimet e parashikuara aty i referohen armëve të zakonshme të qitjes, ose pjesëve të tyre, në gjendje për përdorim, të parashikuar nga neni 44 i dekretit mbretëror të 6 majit 1940, n. 635.

Dënimet e përcaktuara në kodin penal për kundërvajtjet në normat për armët që nuk i parashikon ky ligj trefishohen. Në çdo rast burgimi nuk mund të jetë më i vogël se tre muaj <sup>(18)</sup> <sup>(19)</sup>.

---

(18) Nen i zëvendësuar kështu nga neni 14, L. i 14 tetorit 1974, n. 497. Nenet 15 e 16 të të njëjtit ligj urdhërojnë gjithashtu në këtë mënyrë:

“Neni 15. Dispozitat e parashikuara në nenin e mësipërm nuk aplikohen në hipotezën e veprës penale të mbajtjes së armës pa leje për mungesë të vlefshmërisë së lejes së mbajtjes së armës edhe për përdorim të gjuetisë si pasojë e mospagimit të taksës së autorizimit qeveritar.

Neni 16. Normat procedurale të këtij ligji vlejné deri në hyrjen në fuqi të kodit të ri të procedurës penale”.

(19) Gjykata Kushtetuese, me urdhrin e 11-18 marsit 1999, nr. 73 (Gazeta Zyrtare e 24 marsit 1999, n. 12, Seria speciale), ka deklaruar pathemelësinë e qartë të çështjes së legjitimitetit kushtetues të neneve 2 e 7, të ngritur në lidhje me nenin 3 të Kushtetutës.

---

8. Nuk dënohet ai që, brenda tridhjetë ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe para vërtetimit të veprës penale, dorëzon armët ose pjesë të tyre, municionet, eksplozivët dhe aparate të tjera vdekjeprurëse të zotëruara në mënyrë të paligjshme, të treguara në nenin e mësipërm 1 ose në nenin 695 të Kodit penal.

9. Për veprat penale të parashikuara nga ky ligj procedohet me gjykim të drejtpërdrejtë.

---

**Sistemi Ligje Italiane**

---

L. 18-6-1969 n. 323

Leje për mbajtjen e armëve për ushtrimin e sportit të qitjes në fluturim.

Publikuar në Gazetën Zyrtare në 8 korrik 1969, nr. 170.

Mbishkrim

Nen i vetëm.

---

**L. 18 qershor 1969, n. 323 <sup>(1)</sup>.****Leje për mbajtjen e armëve për ushtrimin e sportit të qitjes në fluturim <sup>(2)</sup>.**

---

(1) Publikuar në Gazetën Zyrtare në 8 korrik 1969, n. 170.

(2) Paragrafi 1 i nenit 1, D. Lgs. 1 dhjetor 2009, n. 179, në dispozitë të kombinuar me bashkëlidhur 1 të të njëjti dekret, ka konsideruar të domosdoshme qëndrimin në fuqi të kësaj mase.

---

**Nen i vetëm.** – Për ushtrimin e sportit të qitjes në fluturim është në kompetencë të kuestorit, duke mbetur i pandryshueshëm respektimi i dispozitave që përmbahen në tekstin unik të ligjeve të sigurisë publike të miratuar me dekretin mbretëror datë 18 qershor 1931, numër 773, dhe modifikime të tjera, t'i japë atij që ka bërë kërkesë, nëse është pa leje për mbajtje armësh të gjata zjarri të dhënë në cilësi tjetër, leje të posaçme që autorizon mbajtjen e armëve të gjata zjarri nga banesa e të interesuarit deri në fushën e qitjes e anasjelltas. Për dhënien e kësaj leje nuk aplikohen dispozitat e parashikuara në ligjin e 2 gushtit 1967, n. 799.

Leja ka kohëzgjatjen prej 6 vjetësh nga dita e lëshimit dhe mund të revokohet nga kuestori në bazë të ligjeve të sigurisë publike.

Vlefshmëria e lejes varet nga pagesa e taksës vjetore të autorizimit qeveritar prej 5000 liretash. Në rast të mospagesës aplikohen dispozitat e parashikuara në nenin 10 të tekstit unik të miratuar me dekretin e Presidentit të Republikës datë 1 mars 1961, n. 121, dhe modifikime të mëtejshme.



## Sistemi Ligje Italiane

---

L. 18-4-1975 n. 110

Norma plotësuese të disiplinës në fuqi për kontrollin e armëve, të municioneve dhe të eksplozivëve.  
Publikuar në Gazetën Zyrtare në 21 prill 1975, nr. 105.

### Mbishkrim

1. *Armë luftarake, armë të ngjashme me ato luftarake dhe municione luftarake.*
2. *Armë dhe municione të zakonshme për qitje.*
3. *Tjetërsim armësh.*
4. *Mbajtje armësh ose objekte të afta për të dëmtuar.*
5. *Kufizime në regjistrime. Ndalim instrumentesh të transformueshëm në armë.*
6. *Komisioni këshillimor qendror për kontrollin e armëve.*
7. *Katalogu kombëtar i armëve të zakonshme të qitjes.*
8. *Vërtetim për lëshimin e autorizimit të policisë në fushën e armëve.*
9. *Kërkesa subjektive për autorizimet e policisë në fushën e armëve.*
10. *Ndalim për zotërimin dhe mbledhjen e armëve luftarake. Koleksion armësh të zakonshme qitje.*
11. *Regjistrim i armëve të zakonshme të qitjes.*
- 11 - bis. *Gjurmimi i armëve dhe i municioneve.*
12. *Importimi përfundimtar i armëve të qitjes.*
13. *Modalitete për importimin përfundimtar të armëve të zakonshme të qitjes.*
- 13-bis. *Futja në treg e armëve të ardhura nga shpura qeveritare.*
14. *Armë të papërshtatshme dhe të pakataloguara.*
15. *Importimi i përkohshëm i armëve të zakonshme të qitjes.*
16. *Eksportimi i armëve.*
17. *Ndalim për shitblerjen e armëve të zakonshme të qitjes të porositura me korrespondencë.*
18. *Modalitete për transportin e armëve dhe eksplozivëve.*
19. *Transporti i pjesëve të armëve.*
20. *Ruajtja e armëve dhe e eksplozivëve. Denoncimi i vjedhjes, humbjes ose gjetjes.*
- 20-bis. *Mos ruajtja e armëve.*
21. *Përvetësim ose grabitje armësh.*
22. *Qiradhënie dhe huapërdorje armësh.*
23. *Armë klandestine.*
24. *Ndalim fabrikimi eksplozivësh të panjohur.*
25. *Regjistër i operacioneve të përditshme.*
26. *Kufizime në zotërim pa denoncim të municioneve.*
27. *Kërkesa subjektive për autorizime në fushën e eksplozivëve.*
28. *Përgjegjësi në përdorimin e eksplozivëve.*

29. *Përvetësim ose grabitje eksplozivësh.*
30. *Armë, municione dhe eksplozivë të Forcave të armatosura dhe të Trupave të Shtetit.*
31. *Mbikëqyrje e aktiviteteve të qitjes në shenjë.*
32. *Mbikëqyrje e armëve dhe municioneve të mbledhura në muze.*
33. *Ankande publike.*
34. *Sanksione penale.*
35. *Gjykim direkt.*
36. *Ndreqje (të veprimeve juridike).*
37. *Dispozita kalimtare dhe përfundimtare.*
- 38.
- 39.
- 40.

**L. 18 prill 1975 n. 110 <sup>(1)</sup>.**

**Norma plotësuese të disiplinës në fuqi për kontrollin e armëve, të municioneve dhe të eksplozivëve.**

---

(1) Publikuar në Gazetën Zyrtare në 21 prill 1975, nr. 105.

---

*(koment jurisprudence)*

**1. Armë luftarake, armë të ngjashme me ato luftarake dhe municione luftarake <sup>(2)</sup>.**

Për efektet e ligjit penal, të atij të sigurisë publike ose të dispozitave të tjera legislative ose rregulluese në këtë fushë janë armë luftarake armët e çdo lloji që, për arsye të fuqisë së tyre të madhe të dëmtimit, janë ose mund të destinohen për armatosjen moderne të trupave kombëtare ose të huaja për përdorim lufte, si edhe bombat e çfarëdolloj tipi ose pjesë të tyre, armë kimike biologjike, radioaktive, aparatura luftarake vdekjeprurëse të çfarëdolloj natyre, shishet ose mbështjellëset eksplozive ose zjarrvënëse <sup>(3)</sup>.

Me përjashtim të asaj që është përcaktuar në paragrafin e dytë të nenit 2, janë armë të ngjashme ato të lutës armët që, edhe pse nuk hyjnë mes armëve luftarake, mund të përdorin të njëjtin municion të armëve luftarake ose janë të parapërgatitura për funksionim automatik për zbatimin e qitjes me breshëri ose paraqesin karakteristika balistike ose përdoruese të zakonshme me armët luftarake.

Janë municione luftarake fishekët dhe gëzhojat përkatëse, predhat ose pjesë të tyre të destinuara për mbushjen e armëve luftarake.

---

(2) Shiko, edhe, paragrafin 1 të nenit 72, D. i Lgs. 6 shtatorit 2011, n. 159.

(3) Paragraf i modifikuar kështu nga neni 1, D. L. i 18 tetorit 2001, n. 374.

---

*(koment jurisprudence)*

**2. Armë dhe municione të zakonshme për qitje.**

Me te njëjtat efekte të treguara në paragrafin e parë të nenit të mësipërm 1 dhe me përjashtim të asaj që urdhërohet në paragrafin e dytë të vetë atij neni janë armë të zakonshme qitje:

- a) pushkët edhe gjysmë automatike me një ose më shumë tyta me kavitet të lëmuar;
- b) pushkët me dy tyta dhe kavitet vija – vija, me mbushje pasuese me veprim manual;
- c) pushkët me dy ose tre tyta të përziera, me kavitet të lëmuar ose me vija, me mbushje pasuese me veprim manual;
- d) pushkët, karabina dhe mushketa me një tytë dhe kavitet me vija, edhe pse të përgatitura për funksionim gjysmë automatik;
- e) pushkët dhe karabinat që përdorin municione me goditje unazore, me kusht që mos të jenë me funksionim automatik;
- f) revolet me rrotullim;
- g) pistoletat me funksionim gjysmë automatik;
- h) riprodhime të armëve antike me mbushje nga gryka modele më të hershme se 1890, me përjashtim të atyre me një goditje të vetme <sup>(4)</sup> <sup>(5)</sup>.

Janë gjithashtu armë të zakonshme qitje pushkët dhe karabinat që, edhe pse mund të përdoren me municion luftarak, paraqesin karakteristika specifike për arsye të përdorimit efektiv për përdorim gjuetie ose sportiv, kanë vëllim të kufizuar zjarri ose janë të destinuara të përdorin municion të ndryshëm nga ato ushtarake. Me përjashtim të rasteve kur janë të destinuara për Forcat e armatosura ose Trupat e armatosura të Shtetit, ose për eksportim, nuk lejohet fabrikimi, futja në territorin e Shtetit dhe shitja e armëve të zjarrit të shkurtra gjysmë automatike ose riprodhime, që mund të mbajnë municion të kalibrit 9x19 të paraluftës, si edhe armë të zakonshme qitje, me përjashtim të asaj që është parashikuar për ato të përdorimit sportiv, për armët antike dhe për riprodhimet e armëve antike, me karikatorë dhe serbatorë, fikse ose të lëvizshme, që përmbajnë një numër më të madh se 5 goditje për armët e gjata dhe një numër më të lartë se 15 goditje për armët e shkurtra, si edhe për gjuetarët dhe çdo mekanizëm të projektuar ose të përshtatur për të zbutur zhurmën e shkaktuar nga një qitje. Për riprodhimet e armëve antike lejohet një numër goditjesh jo më shumë se 10. Në rastet e lejuara kërkohet leja e parashikuar në nenin 31 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike, të aprovuar nga dekreti mbretëror i 18 qershorit 1931, n. 773 <sup>(6)</sup>.

Së fundi konsiderohen armë të zakonshme qitje ato të quajtura “të shënjestrës së sallës”, ose për lëshimin e gazit, si edhe armët me ajër të ngjeshur ose gaz të ngjeshur, qofshin të gjata qofshin të shkurtra predhat e të cilave lëshojnë një energji kinetike më të lartë se 7,5 joule, dhe instrumentet e raketahedhëseve, përveç rastit nëse bëhet fjalë për armë të destinuara për peshkim ose për armë dhe instrumente për të cilat Banka kombëtare e

provës përjashton, në lidhje me karakteristikat përkatëse, prirjen për të dëmtuar personin. Nuk janë armë instrumentet me ajër të ngjeshur ose gaz të ngjeshur me tytë të lëmuar dhe me funksionim jo automatik, të destinuar për lëshimin e kapsulave sferike damkuese të biodegradueshme, pa substancën ose preparatet e parashikuara në nenin 2, paragrafi 2, të dekretit legjislativ të 3 shkurtit 1997, n. 52, që lëshojnë një energji kinetike jo më të lartë se 12,7 joule, mjaft që mos të jetë e një kalibri më të ulët se 12,7 milimetra dhe jo më të lartë se 17,27 milimetra. Banka kombëtare e provës, me shpenzimet e të interesuarit, procedon me verifikimin e përputhjes së prototipave të vetë instrumenteve. Instrumentet që lëshojnë një energji kinetike më të lartë se 7,5 joule mund të përdoren vetëm për aktivitet sportiv. Në rast të mosrespektimit të dispozitave të parashikuar në këtë paragraf, aplikohet sanksioni administrativ i parashikuar në nenin 17-bis, paragrafi i parë, i dekretit mbretëror të 18 qershorit 1931, n. 773. Me dekretin e Ministrit të brendshëm janë përcaktuar dispozitat për blerjen, zotërimin, transportin, mbajtjen dhe përdorimin e instrumenteve që duhen përdorur për aktivitetin amatoresk dhe për atë sportiv <sup>(7)</sup> <sup>(8)</sup>.

Municipionet me saçme të destinuar për armët e qitjes së zakonshme nuk mundet sidoqoftë të krijohen me fishekë me bërthamë me vrima, gjurmëlënëse, zjarrvënëse, me mbushje eksplozive, me ekspansion, vetështytëse, as mund të jenë të tilla që të lëshojnë substanca narkotike, toksike ose gërryese ose kapsula sferike damkuese, të ndryshme nga ato të lejuara sipas normës së paragrafit të tretë dhe përjashtohen fishekët që hedhin substanca dhe instrumentet narkotizuese të destinuar për qëllime shkencore dhe për kafshët për të cilat lëshohet leja e posaçme nga kuestori <sup>(9)</sup>.

Dispozitat e tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773, të Dekretit Mbretëror të majit 1940, n. 635, me modifikimet pasuese përkatëse dhe të këtij ligji për zotërimin dhe mbajtjen e armëve nuk aplikohen përkundrejt instrumenteve raketahedhëse ose të municioneve përkatëse kur përdorimi i tyre parashikohet nga dispozita legjislative ose rregulluese ose kur zotërohen dhe mbahen për t'u përdorur si instrumente të sinjalizimit për mbrojtje, shpëtim ose aktivitete të mbrojtjes civile <sup>(10)</sup> <sup>(11)</sup>.

(4) Gërma është modifikuar kështu nga neni 11, L. i 21 dhjetorit 1999, n. 526.

(5) Shiko, edhe, paragrafin 1 të nenit 72, D. Lgs. i 6 shtatorit 2011, n. 159.

(6) Paragraf i modifikuar kështu nga gërma a) e paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010, dhe më pas nga n. 1) i gërmës a) të paragrafit 1 të nenit 2, D. Lgs i 29 shtatorit 2013, nr. 121. Shiko edhe paragrafin 1 të nenit 72, D. Lgs. i 6 shtatorit 2011, nr. 159.

(7) Paragraf në fillim i zëvendësuar nga neni 1, L. i 21 shkurtit 1990, n. 36 dhe më pas i modifikuar kështu nga neni 11, L. i 21 dhjetorit 1999, n. 526 dhe nga n. 2) e 3) të gërmës a) të paragrafit 1 të nenit 2, D. Lgs. i 29 dhjetor 2013, n. 121. Shiko, edhe, D. M. 12 maj 2011, n. 103.

(8) Gjykata Kushtetuese, me urdhrin e 24-28 nëntorit 2003, nr. 347 (Gazeta Zyrtare e 3 dhjetorit 2003, n. 48, Seria 1<sup>a</sup> speciale), ka deklaruar pathemelësinë e qartë të çështjes së legjitimitetit kushtetues të nenit 2, paragrafi 3, si është i modifikuar nga neni 11 i ligjit të 21 dhjetorit 1999, n. 526 të ngritur në lidhje me nenin 3, 24, paragrafi i dytë, dhe 27, paragrafi i parë, të Kushtetutës.

(9) Paragraf i modifikuar kështu në fillim nga neni 12, D. L. i 8 qershorit 1992, n. 306 dhe më pas nga n. 4) i gërmës a) i paragrafit 1 të artikullit 2, D. Lgs. i 29 shtatorit 2013, n. 121.

(10) Me L. e 6 marsit 1987, n. 89 (Gazeta Zyrtare e 18 marsit 1987, n. 64) u aprovuan normat për verifikimin mjekësor të aftësisë në mbajtjen e armëve dhe për përdorimin e mjeteve të sinjalizimeve me drita për ndihmën alpine. Më pas, me D. M. të 15 shtatorit 1989 (Gazeta Zyrtare e 18 tetorit 1989, n. 244) u diktuan kushtet dhe karakteristikat teknike dhe strukturore të instrumenteve raketahedhëse dhe të municioneve përkatëse për t'u përdorur në ndihmën alpine. Shiko, edhe, D. M. 9 gusht 2001, n. 362.

(11) Paragraf i modifikuar kështu nga neni 1, L. i 21 shkurtit 1990, n. 36.

---

*(koment jurisprudence)*

### **3. Tjetërsim armësh <sup>(12)</sup>.**

Kushdo që, duke ndërruar në çfarëdolloj mënyre karakteristikat mekanike ose dimensionet e një arme, i shton fuqinë dëmtuese, ose e bën më të lehtë mbajtjen, përdorimin ose fshehjen, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet ose me gjobë nga 309 euro deri në 2.065 euro <sup>(13)</sup>.

---

(12) Shiko, edhe, paragrafin 1 të nenit 72, D. Lgs. i 6 shtatorit 2001, nr. 159.

(13) Masa e gjobës është rritur kështu nga neni 113, paragrafi i katërt, L. i 24 nëntorit 1981, n. 689.

---

*(koment jurisprudence)*

### **4. Mbajtje armësh ose objekte të afta për të dëmtuar.**

Me përjashtim të autorizimeve të parashikuara nga paragrafi i tretë i nenit 42 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, numër 773, dhe modifikimeve

pasuese, nuk mund të mbahen, jashtë nga banesa personale ose shtojcat e saj, armë, çomange prej hekuri ose shufra hekuri, shkopa polici, grushte hekuri trulllosës elektrike dhe aparate të tjerë analoge në gjendje të përhapin shkarkesa elektrike <sup>(14)</sup>.

Pa motiv të justifikueshëm, nuk mund të mbajnë me vete, jashtë nga banesa personale ose shtojcat e saj, shkopinj të pajisur me majë hekuri të mprehtë, instrumente me majë ose prerje në gjendje të dëmtojnë, çomange, tuba, zinxhirë, llastiqe, bulona, sfera metalike, si edhe çfarëdolloj instrumenti që nuk konsiderohet shprehimisht si armë me majë ose me prerje, qartësisht e përdorshme, për shkak të rrethanave kohore dhe vendore, për dëmtimin e personit, instrumentet e parashikuara në nenin 5, paragrafi katër, si edhe shënjes laser ose objekte me funksion shënjimi me laser, të klasës së barabartë ose më lart se 3 b, sipas normave të CEI EN 60825 – 1, CEI EN 60825 – 1/A11, CEI EN 60825 – 4 <sup>(15)</sup>.

Kundërvajtësi dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në dy vjet dhe me gjobë nga 1.000 euro deri në 10.000 euro. Në raste të rëndësishme jo të madhe, që i referohen vetëm mbajtjes së objekteve në gjendje të dëmtojnë, mund të jepet vetëm dënimi me gjobë. Dënimi shtohet nëse veprimi ndodh gjatë ose në rastin e manifestimeve sportive <sup>(16)</sup>.

Ndalohet mbajtja e armëve në mbledhjet publike edhe për personat e pajisur me leje. Shkelësi i rregullit dënohet me burgim nga një deri në tre vjet dhe me gjobën nga 3.000 euro deri në 20.000 euro. Dënimi është burgimi nga tre deri në gjashtë vjet dhe gjoba nga 5.000 euro deri në 20.000 euro kur veprimi është kryer nga persona të papajisur me leje <sup>(17)</sup>.

Kushdo që jashtë rasteve të parashikuara nga paragrafi i mësipërm, mban në një mbledhje publike një instrument të përfshirë mes atyre të treguar në paragrafin e parë ose në paragrafin e dytë, dënohet me burgim nga gjashtë deri në dymbëdhjetë muaj dhe me gjobën nga 2.000 euro deri në 20.000 euro <sup>(18)</sup>

Dënimi i parashikuar në paragrafin e tretë dyfishohet kur ekziston njëra nga rrethanat e parashikuara nga neni 4, paragrafi i dytë, i ligjit të 2 tetorit 1967, n. 895, përveç rastit kur përdorimi është element përbërës ose rrethanë rënduese specifike për veprën penale të kryer <sup>(19)</sup>.

[Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore duhet të procedojnë me arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë të shkeljes së normave të paragrafëve të mësipërm katër dhe pesë] <sup>(20)</sup>.

Me dënimin duhet të urdhërohet edhe konfiskimi i armëve dhe i objekteve të tjera dëmtuese.

Janë shfuqizuar neni 19 dhe paragrafi i parë dhe i dytë i nenit 42 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershor 1931, n. 773, dhe modifikimet vijuese.

Nuk konsiderohen armë për qëllimet e dispozitave penale të këtij neni shkopat e flamujve, të tabelave dhe të parrullave në beze të përdorura në manifestimet publike dhe

në kortezhe, as objektet e tjera simbolike të përdorura në të njëjtat rrethana, përveçse nëse përdoren si objekte ganduese.

---

(14) Paragraf i modifikuar kështu nga numri 1) i gërmës b) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. të 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(15) Paragraf i modifikuar kështu nga numri 2) i gërmës b) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. të 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(16) Paragraf i modifikuar kështu në fillim nga neni 113, paragrafi katër, L. i 24 nëntorit 1981, n. 689 më pas nga neni 2, D. L. i 20 gushtit 2001, n. 336, si është modifikuar nga ligji përkatës i konvertimit dhe, së fundi, nga numri 3) i gërmës b) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. të 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(17) Paragraf i modifikuar kështu në fillim nga neni 113, paragrafi katër, L. i 24 nëntorit 1981, n. 689 më pas nga numri 4) i gërmës b) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(18) Paragraf i modifikuar kështu në fillim nga neni 113, paragrafi katër, L. i 24 nëntorit 1981, n. 689 më pas nga numri 5) i gërmës b) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. të 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(19) Paragraf i zëvendësuar kështu nga paragrafi 31 i nenit 3, L. i 15 korrikut 2009, n. 94.

(20) Paragraf i shfuqizuar nga neni 8, D. L. i 26 prillit 1993, n. 122.

---

*(koment jurisprudence)*

**5. Kufizime në regjistrime. Ndalim i instrumenteve të transformueshëm në armë <sup>(21)</sup>.**

Dispozitat e parashikuara në paragrafin e parë të nenit 55 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773 dhe kodifikimet e mëtejshme, nuk aplikohen në shitjen me pakicë të fishekëve të gjuetisë me saçme, të gëzhojave përkatëse ose të kapsollave si edhe në shitjen e saçmave për armët me ajër të ngjeshur <sup>(22)</sup>.

Neni 4 – bis i dekret – ligjit të 22 nëntorit 1956, n. 1274, i konvertuar në ligjin e 22 dhjetorit 1956, n. 1452, është shfuqizuar.



Dispozitat e tekstit unik të cituar, të Dekretit Mbretëror të 6 majit 1940, nr. 635, dhe ato të këtij ligji nuk aplikohen në instrumentet e këtij neni <sup>(23)</sup>.

Instrumentet riprodhues të armëve nuk mund të fabrikohen me përdorimin e teknikave dhe të materialeve që lejojnë transformimin në armë luftarake ose të zakonshme qitje ose që lejojnë përdorimin e municioneve përkatëse ose të hedhjes së objekteve të afta për dëmtimin e personit. Instrumentet e mësipërm nëse janë të realizuar në metal duhet ta kenë tytën tërësisht të bllokuar, jo në gjendje të mbajë fishekë dhe të ketë tytë të mbyllur nga një tapë e kuqe që nuk mund të hiqet. Ato të sinjalizimit akustik, të destinuar për të krijuar një zhurmë nëpërmjet ndezjes së një fisheku mësimit, duhet të kenë tytën e mbyllur nga një insert metali dhe një tapë e kuqe e palëvizshme në ekstremitetet e tytës.

Instrumentet e quajtur “softair”, që u shiten vetëm personave më të mëdhenj se 16 vjeç, mund të gjuajnë saçme plastike, me ngjyrë të ndezur, me ajër ose gaz të ngjeshur, mjaft që energjia e saçmës së veçantë, e matur një metër nga pjesa e vjaskuar e tytës, të mos jetë më shumë se 1 joule. Tyta e armës duhet të jetë me ngjyrë të kuqe për të paktën 3 centimetra dhe nëse tyta nuk është e kërcyer boja duhet të jetë në pjesën e përparme të instrumentit në një pjesë të tij në mënyrë të njëjtë.

Instrumentet e përmendur në këtë paragraf i nënshtrohen, me shpenzimet e të interesuarit, verifikimit të përputhjes së vërtetuar nga Banka kombëtare e provës <sup>(24)</sup>.

Asnjë kufizim për pamjen e instrumenteve riprodhues të armëve të destinuara për eksportimin <sup>(25)</sup>.

Kushdo që prodhon ose nxjerr për tregti instrumente të përmendur në këtë nen, pa respektuar dispozitat e paragrafit të katërt, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet dhe me gjobë nga 1.500 euro deri në 15.000 euro <sup>(26)</sup>.

Kur përdorimi ose mbajtja e armëve parashikohet si element përbërës ose rrethanë rënduese e veprës penale, vetë vepra penale ekziston ose rëndohet edhe nëse bëhet fjalë për armë për përdorim skenik ose instrument riprodhues armësh tyta e të cilës nuk është e mbyllur sipas normës së paragrafit të katërt <sup>(27)</sup>.

(21) Rubrikë e modifikuar kështu nga numri 1) i germës c) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(22) Paragraf i modifikuar në këtë mënyrë nga neni 10, L. i 25 janarit 2006, n. 29 – Ligji i Komunitetit 2005.

(23) Paragraf i modifikuar kështu nga numri 2) i gërmës c) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(24) Paragraf i modifikuar kështu nga numrat 1 e 3 të gërmës c) të paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010, dhe më pas nga germa b) e paragrafit 1 të nenit 2, D. Lgs. i 29 shtatorit 2013, n. 121.

(25) Paragraf i modifikuar kështu nga numri 1) i gërmës c) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(26) Paragraf i modifikuar fillimisht nga neni 2, L. i 21 shtatorit 1990, nr. 36 dhe më pas i zëvendësuar nga numri 4) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(27) Paragraf i modifikuar kështu nga numri 1) i gërmës c) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

---

*(komment jurisprudence)*

#### **6. Komisioni këshillimor qendror për kontrollin e armëve.**

Është i ngritur pranë Ministrisë së brendshme, komisioni këshillimor qendror i armëve. Komisioni përbëhet nga një kryetar, dy përfaqësues të Ministrisë së brendshme, njëri prej të cilëve nga Policia e Shtetit, dy nga Ministria e mbrojtjes, prej të cilëve njëri i Armës së Karabinierëve, pesë nga Ministria e Industrisë, e tregtisë dhe e artizanatit, prej të cilëve katër si përfaqësuese të sektorëve ekonomikë të interesuara, me emërim të shumëfishtë nga shoqatat e kategoritë më përfaqësuese, një nga Ministria e tregtisë me jashtë, dy nga Ministria e financave, njëri prej të cilëve i drejtorisë së përgjithshme të doganave dhe tjetri i Policisë Financiare, tre ekspertë në fushën balistike dhe një ekspert armësh antike, artistike, të rralla por sidoqoftë me rëndësi historike <sup>(28)</sup>.

Funksionet e sekretarit ushtrohen nga një funksionar i drejtorisë së përgjithshme të sigurisë publike.

Kryetari dhe anëtarët e komisionit emërohen me dekret të Ministrit të brendshëm, rrinë në detyrë pesë vjet dhe mund të rikonfirmohen. Për secilin anëtar efektiv emërohet një zëvendës.

Në rast të mungesës ose të pengesës së kryetarit, i ushtron funksionet e tij anëtari efektiv i deleguar çdo vit nga kryetari; në rast mungese ose pengese të anëtarëve efektivë, i kryejnë detyrat e tyre zëvendësit.

Komisioni shpreh mendimin e detyrueshëm mbi katalogimin e armëve të prodhuara ose të importuara në territorin e Shtetit, duke verifikuar që ato, edhe për shkak të karakteristikave të tyre, nuk hyjnë në kategoritë e parashikuara nga neni i mësipërm 1, si edhe për të gjitha çështjet me karakter të përgjithshëm dhe normativ në lidhje me armët dhe me masat e sigurisë për sa i takon fabrikimit, riparimit, depozitimit, ruajtjes, tregtisë, importimit, eksportimit, zotërimit, mbledhjes, koleksionit, transportit dhe përdorimit të armëve <sup>(29)</sup> <sup>(30)</sup>.

---

(28) Paragraf i zëvendësuar në këtë mënyrë nga neni 1, L. i 16 korrikut 1982, n. 452 (Gazeta Zyrtare e 20 korrikut 1982, n. 197). Shiko, edhe, D. P. R. e 9 majit 1994, n. 608.

(29) Paragraf i zëvendësuar në këtë mënyrë nga neni 2, L. i 16 korrikut 1982, n. 452 (Gazeta Zyrtare e 20 korrikut 1982, n. 197), i ratifikuar me njoftim publik në Gazetën Zyrtare të 23 korrikut 1982, n. 201.

(30) Shiko, edhe, nenet 1 dhe 3, D. P. R. e 14 majit 2007, n. 85.

---

*(koment jurisprudence)*

### **7. Katalogu kombëtar i armëve të zakonshme të qitjes.**

[Është ngritur pranë Ministrisë së brendshme katalogu kombëtar i armëve të zakonshme të qitjes, me përjashtimin e pushkëve të gjuetisë me kavitet të lëmuar dhe e riprodhimeve të armëve me mbushje nga përpara, për të cilat është pranuar prodhimi ose importimi përfundimtar <sup>(31)</sup>.

Katalogimi i prototipave të prodhimit të ri ose i importimit të ri do të bëhet mbi bazën e skicave dhe të karakteristikave të treguara në kërkesën ose tek vetë prototipat.

Paraqitja e prototipit nuk kërkohet sidoqoftë për pushkët e gjuetisë me kavitet të lëmuar, si edhe për riprodhimet e armëve antike me mbushje nga përpara, në regjistrimin e të cilave në katalog procedohet duke mbajtur parasysh disa karakteristika të përbashkëta për këto armë <sup>(32)</sup>.

Regjistrimi i armës në katalog përbën vërtetimin përfundimtar të cilësisë së armës së zakonshme të qitjes të zotëruar nga prototipi.

Në katalog tregohen:

numri progresiv i regjistrimit;

përshkrimi i armës dhe kalibri;

prodhuesi dhe importuesi;

shteti ku është prodhuar arma ose nga i cili është importuar.

Konfeksionet artistike ose artizanale nuk e ndryshojnë prototipin nëse mbesin të pandryshueshme cilësitë balistike, kalibri dhe pjesët mekanike të tij.

Me dekrete të tij që duhen publikuar në Gazetën Zyrtare, Ministri i Brendshëm përcakton:

1) datën e fillimit të operacioneve të katalogimit;

2) modalitetet për regjistrimin në katalog dhe ato për refuzimin e regjistrimit;

3) modalitetet për publikimin dhe përditësimet e katalogut <sup>(33)</sup> <sup>(34)</sup>.

(31) Paragraf i zëvendësuar në këtë mënyrë nga neni 3, L. i 16 korrikut 1982, n. 452 (Gazeta Zyrtare e 20 korrikut 1982, n. 197).

(32) Paragraf i shfuqizuar nga neni 4, L. i 16 korrikut 1982, n. 452 (Gazeta Zyrtare e 20 korrikut 1982, n. 197).

(33) Shiko shënimin 13/a të nenit 11.

(34) Nen i shfuqizuar nga paragrafi 7 i nenit 14, L. i 12 nëntorit 2011, n. 183, duke filluar nga 1 janari 2012, në bazë të sa është urdhëruar nga paragrafi 1 i nenit 36 i të njëjtit ligj n. 183/2011.

## **8. Vërtetim për lëshimin e autorizimit të policisë në fushën e armëve.**

Kërkesa për marrjen e lejes për blerjen ose dhënien e armëve, në bazë të nenit 35, paragrafi i tretë, i tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773, i modifikuar me dekret ligjin e 22 nëntorit 1956, n. 1274, i konvertuar në ligjin e 22 dhjetorit 1956, n. 1452, duhet të tregojë motivet e blerjes ose të dhënies.

Leja e parashikuar në nenin 31 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike kërkohet edhe për ushtrimin e industrisë së riparimit të armëve.

Lëshimi i autorizimeve për fabrikimin, mbledhjen, tregtinë, depozitimin dhe riparimin e armëve, si edhe të lejes së mbajtjes së armëve, të parashikuara nga nenet 28, 31, 32, 35 dhe 42 të tekstit unik të sipërpërmendur dhe 37, të dekretit mbretëror të 6 majit 1940, n. 635, dhe nga ky ligj, i nënshtrohet vërtetimit të aftësive teknike të kërkuesit. Vërtetimi nuk nevojitet për autorizimin për koleksion <sup>(35)</sup>.

Për qëllimet e vërtetimit të aftësisë teknike, i interesuari duhet të bëjë një ekzaminim të posaçëm pranë komisionit të parashikuar në nenin 49 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike. Komisioni është i plotësuar nga një ekspert i Ministrisë së mbrojtjes kur vërtetimi kërkohet nga person që duhet të ushtrojë aktivitet fabrikimi, riparimi ose tregtie armësh.

Dispozitat e parashikuara në paragrafët e mësipërm aplikohen gjithashtu për personat që përfaqësojnë, sipas nenit 8 të tekstit të cituar unik, titullarin e autorizimit të policisë.

Ata që në dhjetë vitet para prezantimit të kërkesës së parë kanë bërë shërbim ushtarak në Forcat e armatosura ose njërën prej trupave të armatosura të Shtetit ose kanë qenë pjesë tek organika e personelit civil të sigurisë publike në cilësinë e funksionarëve ose që paraqesin çertifikatë të përshtatshmërisë së përdorimit të armëve të lëshuar nga seksioni kompetent i Federatës kombëtare së qitjes në shenjë duhet t'i nënshtrohen vërtetimit teknik vetëm për ushtrimin e aktivitetit të fabrikimit, riparimit ose të tregtisë së armëve <sup>(36)</sup>.

Vërtetimi i aftësisë teknike nuk kërkohet për blerjen dhe për mbajtjen e armëve nga ana e atyre që janë të autorizuar me ligj.

Aftësia teknike supozohet për ata që, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, i kanë marrë autorizimet ose kanë përmbushur detyrimet e parashikuara për këtë fushë nga dispozitat e tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike dhe të Dekretit Mbretëror të 6 majit 1940, n. 635.

Ata që ushtrojnë industrinë e riparimit të armëve duhet t'i kërkojnë organit kompetent shtetëror të sigurisë publike lejen e parashikuar në paragrafin e dytë të këtij neni brenda afatit prej dyzet e pesë ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 33 i Tekstit Unik të ligjeve të sigurisë publike të datës 18 qershor 1931, n. 773, është shfuqizuar.

---

(35) Paragraf i zëvendësuar kështu nga neni 3, L. i 21 shkurtit 1990, n. 36.

(36) Paragraf i modifikuar kështu nga gërma d) e paragrafit 1 të nenit 5, D.Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të njëjtë D. Lgs. n. 204/2010.

---

*(komment jurisprudence)*

**9. Kërkesa subjektive për autorizimet e policisë në fushën e armëve.**

Përveç sa është përcaktuar nga neni 11 i Tekstit Unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773, dhe modifikimet e mëtejshme, autorizimet e policisë së caktuara për fabrikimin, mbledhjen, tregtinë, importimin, eksportimin, koleksionin, depozitimin, riparimin dhe transportin e armëve të çfarëdolloj tipi nuk mund t'u lëshohen personave që ndodhen në kushtet e treguara në nenin 43 të vetë tekstit unik. Për lëshimin e këtyre autorizimeve, organi kompetent shtetëror i sigurisë publike mund t'u kërkojë të interesuarve prezantimin e çertifikatës të parashikuar në paragrafin e katërt të nenit 35 të Tekstit Unik të cituar të modifikuar me D. L. e datës 22 nëntor 1956, n. 1274, të konvertuar në L. e datës 22 dhjetor 1956, n. 1452.

Mbesin të pandryshuara dispozitat e nenit 8 të Ligjit të 31 majit 1965, n. 575, autorizimet e parashikuara në paragrafin e parë nuk mund t'u lëshohen atyre që u janë nënshtruar njëjës prej masave të sigurimit të parashikuara nga ligji i 27 dhjetorit 1956, nr. 1423<sup>(37)</sup>.

(37) Shiko, edhe, nenet 1 dhe 3, D. P. R. e 14 majit 2007, n. 85.

---

*(komment jurisprudence)*

**10. Ndalim për zotërimin dhe mbledhjen e armëve luftarake. Koleksion armësh të zakonshme qitje.**

Duke nisur nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nuk mund të lëshohen leje për zotërimin dhe mbledhjen e armëve luftarake, ose të ngjashme me ato luftarake, ose pjesë të tyre, ose të municioneve luftarake.

Armët për të cilat është autorizuar zotërimi ose mbledhja në bazë të nenit 28 të Tekstit Unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, nr. 773, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund të transferohen vetëm me suksesim për shkak të vdekjes, për shkak të pagesës pranë organeve kompetente të Ministrisë së mbrojtjes, për shkak të dhënies së enteve publike të parashikuar në paragrafin e pestë dhe subjekteve të pajisur me autorizim për fabrikimin e armëve luftarake ose të llojit të ngjashëm me ato luftarake ose të municioneve luftarake ose për shkak të dhënies, duke respektuar normat në fuqi për eksportimin e këtyre armëve, enteve ose personave me banim jashtë shtetit. Trashëgimtari, privati ose enti publik të cilit i vijnë, të gjitha ose pjesë të tyre, këto armë është i detyruar të njoftojë menjëherë Ministrinë e brendshme dhe të kërkojë lëshimin e autorizimit të posaçëm për t'i ruajtur ato. Meqë janë të aplikueshme të vërehen dispozitat e neneve të mëparshme 8 dhe 9.

Kushdo që i transferon armët e parashikuara në nenin 28 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike për arsye të ndryshme nga ato të treguara në paragrafin e mëparshëm dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet dhe me gjobë nga 2.000 euro deri në 20.000 euro <sup>(38)</sup>.

Dënohet me gjobë deri në 1.000 euro kushdo që, duke qenë i detyruar, nuk bën njoftimin e parashikuar nga paragrafi i dytë i këtij neni.

Përveç normativës që ka të bëjë me pajisjet e armëve të Forcave të armatosura dhe me Trupat e armatosura të Shtetit, lejohet mbajtja dhe mbledhja e armëve të materialeve të treguara në paragrafin e parë nga Shteti dhe, në kuadër të kompetencave të tyre, entet publike në lidhje me ushtrimin e aktivitetit me karakter historik ose kulturor si edhe subjekte të pajisur me autorizime për fabrikimin e armëve luftarake ose të llojeve të ngjashme luftarake ose të municioneve luftarake për nevoja studimi, eksperimenti, kolaudimi <sup>(39)</sup>.

Mbajtja e armëve të zakonshme të qitjes për qëllime të ndryshme nga at të parashikuara nga neni 31 i tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike, i aprovuar me Dekretin Mbretëror të 18 qershorit 1931, n. 773, lejohet në numrin tre për armët e zakonshme të qitjes dhe gjashtë për armët për përdorim sportiv. Për armët e gjuetisë mbetet i vlefshëm dispozitivi i nenit 37, paragrafi 2, i ligjit të 11 shkurtit 1992, n. 157 <sup>(40)</sup>. Mbajtja e armëve të zakonshme të qitjes në masë më të lartë i nënshtrohet lëshimit të lejes së posaçme të koleksionit nga ana e kuestorit, në kufirin e një ekzemplari për çdo model të katalogut kombëtar; kufiri i një ekzemplari për çdo model nuk aplikohet për pushkët e gjuetisë me kavitet të lëmuar dhe për riprodhimet e armëve me mbushje nga përpara <sup>(41) (42)</sup>.

Nuk ndryshojnë dispozitat e tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773, për armët antike. Janë armë antike ato me mbushje nga përpara dhe ato të fabrikuara para vitit 1890. Për armët antike, artistike ose të rralla të rëndësisë historike e modeleve të para vitit 1890 do të përgatitet një rregullore e posaçme që duhet të nxirret nga Ministri i brendshëm në bashkëpunim me Ministrin e trashëgimisë kulturore brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Këto armë nuk llogariten për qëllimet e parashikuara në paragrafin e gjashtë <sup>(43)</sup>.

Kërkesa e lejes së kuestorit duhet të bëhet nga ana e atyre që mbajnë armë të zakonshme qitje në sasi më të madhe se ato të treguara në paragrafin e gjashtë brenda afatit të njëqind e tetëdhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Për mbledhjen dhe koleksionin e armëve të çfarëdolloj tipi përjashtohet mbajtja e municionit përkatës. Ndalimi nuk aplikohet në mbledhjet për arsye tregtare dhe industriale <sup>(44)</sup>.

Kushdo që nuk respekton detyrimet ose ndalimet e parashikuara në paragrafin e gjashtë, të tetë dhe të nëntë dënohet me burgim nga një deri në katër vjet dhe me gjobë nga 1.500 euro deri në 10.000 euro <sup>(45) (46) (47)</sup>.

---

(38) Paragraf i modifikuar kështu në fillim nga neni 113, paragrafi katër, L. i 24 nëntorit 1981, n. 689 më pas nga numri 1) i gjermës e) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(39) Paragraf i modifikuar kështu në fillim nga neni 113, paragrafi katër, L. i 24 nëntorit 1981, n. 689 më pas nga numri 2) i gjermës e) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010. Për efekte të nenit 26 të kodit penal, madhësia e sanksionit nuk mund të jetë më e ulët se 20 euro. Sanksioni përjashtohet nga depenalizimi në bazë të nenit 34, paragrafi i parë, germa c), i ligjit të përmendur të 24 nëntorit 1981, n. 689.

(40) Fjali e zëvendësuar kështu, në fillim, nga neni 1, L. i 25 marsit 1986, n. 85, më pas i modifikuar nga neni 4, L. i 21 shkurtit 1990, n. 36, i zëvendësuar përsëri nga neni 12, D. L. i 8 qershorit 1992, n. 306, dhe së fundi i modifikuar kështu nga neni 9, L. i 19 dhjetorit 1992, n. 489.

(41) Paragraf i zëvendësuar kështu nga neni 5, L. i 16 korrikut 1982, n. 452 (Gazeta Zyrtare e 20 korrikut 1982, n. 197). Shiko, edhe, neni 37, L. i 11 shkurtit 1992, n. 157.

(42) Gjykata Kushtetuese, me urdhrin e 12-21 marsit 1997, nr. 68 (Gazeta Zyrtare e 26 marsit 1997, n. 13, Seria speciale), ka deklaruar pathemelësinë e qartë të çështjes së legjitimitetit kushtetues të nenit 10, paragrafët gjashtë, nëntë dhe dhjetë të ngritura në lidhje me nenin 3, paragrafi i dytë, dhe 42, paragrafi i dytë, të Kushtetutës.

(43) Shiko D. M. të 14 prillit 1982.

(44) Gjykata Kushtetuese, me urdhrin e 12-21 marsit 1997, nr. 68 (Gazeta Zyrtare e 26 marsit 1997, n. 13, Seria speciale), ka deklaruar pathemelësinë e qartë të çështjes së legjitimitetit kushtetues të nenit 10, paragrafët gjashtë, nëntë dhe dhjetë të ngritur në lidhje me nenin 3, paragrafi i dytë, dhe 42, paragrafi i dytë, të Kushtetutës.

(45) Paragraf i modifikuar kështu në fillim nga neni 113, paragrafi katër, L. i 24 nëntorit 1981, n. 689 më pas nga numri 3) i gjermës e) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(46) Gjykata Kushtetuese, me urdhrin e 12-21 marsit 1997, nr. 68 (Gazeta Zyrtare e 26 marsit 1997, n. 13, Seria speciale), ka deklaruar pathemelësinë e qartë të çështjes së legjitimitetit kushtetues të nenit 10, paragrafët gjashtë, nëntë dhe dhjetë të ngritur në lidhje me nenin 3, paragrafi i dytë, dhe 42, paragrafi i dytë, të Kushtetutës.



(47) Gjykata Kushtetuese, me urdhrin e 24-28 majit 2004, n. 158 (Gazeta Zyrtare e 3 qershorit 2004, Botim i jashtëzakonshëm), ka deklaruar pathemelësinë e qartë të çështjes së legjitimitetit kushtetues të nenit 10, paragrafi dhjetë, e ngritur në lidhje me nenin 3 dhe 27 të Kushtetutës.

---

*(komment jurisprudence)*

### **11. Regjistrim i armëve të zakonshme të qitjes.**

Për armët e prodhuara, të montuara dhe të futura në territorin e Shtetit, duhet të vulosen në mënyrë që mos të hiqet kurrë, në një zonë të kufizuar të shtratit, skeletit ose të kullës ose të një pjese thelbësore të armës, të parashikuar në nenin 1-bis, paragrafi 1, germa c), të dekretit legjislativ të 30 dhjetorit 1992, n. 527, dhe nën kujdesin e fabrikuesit ose të montuesit, emri, sigla ose marka e fabrikuesit ose e montuesit, viti dhe Shteti ose vendi i fabrikimit dhe, aty ku parashikohet, numri i regjistrimit të prototipit ose të ekzemplarit në katalogun kombëtar, si edhe numri i matrikullit. Një numër progresiv duhet gjithashtu të vuloset tek tytat e ndërkëmbyeshme të armëve. Kalibri duhet të riprodhohet të paktën mbi tytë. Çdo vulosje duhet të vendoset mbi një pjesë të dukshme të armës ose lehtësisht të kontrollueshme pa mjete. Mbetet e pandryshuar ajo që është parashikuar nga neni 32, paragrafi i nëntë dhe i dhjetë, lejohet zëvendësimi i pjesës së armës ku vendoset vula nëse bëhet e papërdorshme, për shkak të thyerjes ose të përdorimit, para derdhjes për mbeturina të saj, nën kujdesin e të interesuarit, tek drejtoria kompetente e artiljerisë. Zona e armës e rezervuar për vulosje nuk mund të mbajë shenja të mëtejshme ose të ndryshme identifikuese ose dalluese të vetë armës. Nën kujdesin e Bankës kombëtare të provës duhet të vendoset sigla e Republikës Italiane dhe e dhëna e vitit kur ka ndodhur futja e armës në territorin kombëtar, me me përjashtim të rastit kur këto të dhëna janë vënë nga një Shtet tjetër anëtar i Bashkimit Europian. Zona e armës së rezervuar për vulosje nuk mund të mbajë shenja identifikuese ose dalluese të mëtejshëm dhe të ndryshme të vetë armës <sup>(48)</sup>.

Përveç detyrave të parashikuara nga neni 1 i ligjit të 23 shkurtit 1960, n. 186, Banka Kombëtare e provës në Gardone Valtrompia, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet seksioneve të saj, vërteton që armët ose tytat e paraqitura mbajnë të dhënat e përshkruara në paragrafin e parë dhe vulos një shenjë dalluese me emblemën e Republikës Italiane dhe siglën e identifikimit të Bankës ose të seksionit. Operacioni duhet të shënohet me caktimin e një numri progresiv në një regjistër të posaçëm i cili duhet mbajtur nën kujdesin e Bankës ose të seksionit. Të dhënat që përmban regjistri i komunikohen edhe në formë telepatike, Ministrisë së brendshme <sup>(49)(50)</sup>.

Armët e zakonshme të qitjes të prodhuara jashtë shtetit që mbajnë shënuesit e provës të njëjës prej bankave të njohura ligjërisht në Itali nuk i nënshtrohen prezantimit në Bankën e provës në Gardone Valtrompia kur mbajnë shenjën dalluese për të cilën u fol në paragrafin e parë. Nëse organi kompetent i sigurisë publike, në kuadrin e aktivitetit të kontrollit, ka motiv të mendojë se armët e përmendura në këtë paragraf, të futura në

territorin e Shtetit nuk përkojnë me prototipin ose me ekzemplarën e regjistruar në katalogun kombëtar, urdhëron që mbajtësi t'ia kalojë vetë armën bankës kombëtare të provës, e cila merr masa për kryerjen e verifikimeve të përputhshmërisë sipas modaliteteve të parashikuara në nenin 14<sup>(51)</sup>.

Nëse mungojnë mbi armët e prodhuara jashtë shtetit shenjat dalluese të përmendura në paragrafin e mësipërm, importuesi duhet të kujdeset për përmbushjet e nevojshme.

Në rast mungese edhe të njërit prej elementëve të treguar në paragrafin e parë Banka ose seksioni merr masa t'i vendosë, në bazë të një kërkesë të motivuar të atyre që e kanë të drejtën, e vërtetuar nga zyra lokale e sigurisë publike ose në mungesë nga komanda e karabinierisë. Për këtë qëllim, në vend të numrit të matrikullit vuloset numri progresiv i regjistrimit të operacionit në regjistrin e përmendur në paragrafin e dytë.

Dispozitat e paragrafit të pestë aplikohen gjithashtu në armët e zakonshme të qitjes dhe në tytat e ndërkëmbyeshme të importuara nga jashtë shtetit. Vërehen për këtë qëllim modalitetet e paraqitura në nenin pasues 13.

Normat e këtij neni për vendosjen mbi armë të numrit të regjistrimit në katalogun kombëtar, aplikohen duke filluar nga data e treguar në dekretin ministror të parashikuar në nenin e mëparshëm 7, paragrafi shtatë n. 1)<sup>(52)</sup>.

Brenda afatit prej një viti nga data e treguar në dekretin për të cilin u fol në paragrafin e mëparshëm duhet të paraqiten tek Banka kombëtare e provës ose tek seksionet e saj, nëse u mungon numri i matrikullit, për vendosjen e këtij të fundit sipas normës të paragrafit të pestë:

armët e zakonshme të qitjes të prodhuara në territorin e Shtetit ose të importuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, me përjashtimin e atyre të prodhuara ose të importuara para vitit 1920;

armët portative të zjarrit për të cilat është folur në nenin e mëparshëm 1 që i përkasin privatëve mbajtja e të cilave lejohet.

Për zbatimin e veprimeve të parashikuara nga ky nen, Bankës kombëtare të provës, përveç të drejtës fikse, që duhet përcaktuar sipas modaliteteve të parashikuara nga neni 3 i ligjit të cituar të 23 shkurtit 1960, n. 186, i jepet *una tantum* një kontribut i jashtëzakonshëm prej 270 milionë liretash në ngarkim të shtetit për parashikimin e shpenzimeve të Ministrisë së industrisë, të tregtisë dhe të artizanatit<sup>(53)</sup>.

Detyrimi prej 270 milionësh parashikohet nëpërmjet reduktimit përkatës të rezervimit të regjistrimit në kapitullin 6856 të gjendjes së parashikimit të Ministrisë së thesarit për vitin 1980, duke përdorur të rast nevoje pjesë të fondit rezervë të parapërgatitur për rinovimin e konventës së Lomesë<sup>(54)</sup>.

Ministri i thesarit është i autorizuar të parashtojë, me dekrete të tij, ndryshimet e duhura të bilancit <sup>(55)</sup>.

(48) Paragraf i modifikuar kështu në fillim nga neni 15, L. i 16 marsit 2006, n. 146 dhe më pas i zëvendësuar kështu nga numri 1) i gjermës f) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(49) Paragraf i modifikuar kështu nga numri 2) i gjermës f) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010. Ky paragraf ishte modifikuar nga germa a) e paragrafit 1 të nenit 1, D.L. i 20 qershorit 2012, n. 79, i shfuqizuar nga ligji i konvertimit të 7 gushtit 2012, n. 131.

(50) Shiko, edhe, nenin 23, paragrafi 12-sexiesdecies, D. L. i 6 korrikut 2012, n. 95, në tekstin e integruar të ligjit të konvertimit të 7 gushtit 2012, m. 135.

(51) Paragraf i modifikuar kështu nga numri 3) i gjermës f) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(52) D. M. i 30 qershorit 1978 (Gazeta Zyrtare e 26 korrikut 1978, n. 207) ka vendosur kështu:

«Katalogu kombëtar i armëve të zakonshme të qitjes do të publikohet brenda 30 shtatorit 1979 dhe do të llogarisë të gjitha regjistrimet e bëra deri në 31 mars 1979».

Për efektet e nenit 11, paragrafi i shtatë, i L. i 18 prillit 1975, n. 110, afati i miratimit mbi armët të numrit të regjistrimit në katalogun kombëtar do të nise nga 1 tetori 1979»

(53) Tre paragrafët e fundit e zëvendësojnë në këtë mënyrë paragrafin e fundit origjinal për efekt të nenit unik, L. i 25 shkurtit 1981, n. 40 (Gazeta zyrtare e 3 majit 1981, n. 61)

(54) Tre paragrafët e fundit e zëvendësojnë në këtë mënyrë paragrafin e fundit origjinal për efekt të nenit unik, L. i 25 shkurtit 1981, n. 40 (Gazeta zyrtare e 3 majit 1981, n. 61)

(55) Tre paragrafët e fundit e zëvendësojnë në këtë mënyrë paragrafin e fundit origjinal për efekt të nenit unik, L. i 25 shkurtit 1981, n. 40 (Gazeta zyrtare e 3 majit 1981, n. 61)

**11-bis.** *Gjurmimi i armëve dhe i municioneve.*

1. Arkivi për të cilin u fol në nenin 3 të dekretit legjislativ të 25 janarit 2010, n. 8, regjistron dhe ruan për jo më pak se pesëdhjetë vjet, për secilën armë zjarri, llojin, markën, modelin, kalibrin dhe numrin e serisë, numrin e katalogut ku parashikohet, si edhe emrat dhe adresat e furnizuesit dhe të blerësit ose të mbajtësit të armës së zjarrit.

2. Në të njëjtin arkiv regjistrohen të dhënat e municioneve të paraqitura në nenin 3 të ligjit të 6 dhjetorit 1993, n. 509, si edhe emrat dhe adresat e furnizuesit dhe të blerësit të vetë municioneve <sup>(56)</sup>.

---

(56) Nen i shtuar nga germa g) e paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

---

## *12. Importimi përfundimtar i armëve të qitjes.*

Kushdo që pa leje për fabrikimin dhe tregtinë e armëve ka ndër mend të importojë armë të zakonshme qitje në numër më të lartë se tre, gjatë të njëjtit vit diellor, përveç lejes së kuestorit të parashikuar në nenin 31 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773, duhet të pajiset me leje të posaçme nga prefekti i provincës ku i interesuari ka banimin e tij sipas gjendjes civile.

Kërkesa për marrjen e lejes së importimit duhet të jetë e motivuar.

Lëshimi i lejes së importimit i nënshtrohet vërtetimit të ekzistencës, në rastet e parashikuara, të autorizimeve të kompetencës të administratave të tjera publike.

Nuk mund të autorizohet importimi i armëve të zakonshme të qitjes nëse nuk e kanë kaluar verifikimin e parashikuar nga neni 23, paragrafi 12-sexiesdecies, i dekret-ligjit të 6 korrikut 2012, n. 95, i konvertuar, me modifikime, nga ligji i 7 gushtit 2012, n. 135 <sup>(57)</sup>.

Kushdo që importon armë në numër më të lartë se tre pa u pajisur me lejen e parashikuar nga paragrafi i parë dënohet me burgim nga një deri në gjashtë vjet dhe me gjobë nga 206 euro deri në 1.549 euro <sup>(58)</sup>.

---

(57) Paragrafi i zëvendësuar kështu nga germa c) e paragrafit 1 të nenit 2, D.Lgs. i 29 shtatorit 2013, n. 121.

(58) masa e gjobës është rritur kështu nga neni 113, paragrafi i katërt, L. i 24 nëntorit 1981, n. 689.

---

**13. Modalitete për importimin përfundimtar të armëve të zakonshme të qitjes.**

Dogana tek e cila paraqiten për importimin përfundimtar armët e zakonshme të qitjes duhet, mbas nacionalizimit, të kujdeset për kalimin, me shpenzimet e importuesit, tek Banka kombëtare e provës në Gardone Valtrompia ose në seksionin më të afërt me atë, me përjashtim të armëve që vijnë nga Shtetet shënuesit e provës të cilëve njihen në bazë të ligjit të 23 shkurtit 1960, n. 186, ligjit të 12 dhjetorit 1973, n. 993, dhe të dispozitave të tjera në fuqi, mjaft që të kenë shenjat dalluese të parashikuara në paragrafin e parë të nenit 11.

Është shfuqizuar paragrafi i fundit i nenit të ligjit të 23 shkurtit 1960, n. 186.

---

**13-bis. Futja në treg e armëve të ardhura nga shpura qeveritare.**

1. Armët në pronësi të Forcave të armatosura të policisë së deklaruar jashtë përdorimit, meqë nuk janë më pajime, mund të futen në tregun civil, me kusht që të çmilitarizohen. Çmilitarizimi konsiston në transformimin e një arme luftarake ose të një lloji të ngjashëm me ato luftarake në një armë të zakonshme qitje.

2. Armët e parashikuara në paragrafin 1 mund t'u jepen vetëm subjekteve të pajisur me autorizimet e nevojshme për blerje. Procedura e çmilitarizimit zbatohet sipas modaliteteve të përcaktuara me dekret të Ministrit të brendshëm.

3. Armët e çaktivizuara mund të tjetërsohen pa autorizim. Janë armë të çaktivizuara ato që i nënshtrohen një operacioni teknik nëpërmjet të cilit arma portative e parashikuar në nenet 1 dhe 2, bëhet inerte dhe sillet në gjendjen e saj thjesht si statujë edhe në pjesët e saj thelbësore, në mënyrë të qëndrueshme dhe të pakthyeshme, sipas modaliteteve të përcaktuara me dekret të Ministrit të Brendshëm.

4. Çmilitarizimi dhe çaktivizimi duhet të zbatohen nga subjekte të pajisur me leje për fabrikimin e armëve luftarake ose të stabilimenteve ushtarake, ose nga subjekte të tjera publike të parashikuar nga neni 10, paragrafi 5, si të pajisur me mjetet e nevojshme teknike. Çaktivizimi për armët e zakonshme mund të zbatohet, përveçse nga subjektet e treguara më sipër për çaktivizimin e armëve luftarake, nga subjektet e pajisura me leje fabrikimi dhe riparim armësh të zakonshme.

5. Para fillimit të procedurave të dhënies së armëve të parashikuara në këtë nen, Administratat e interesuara duhet t'i komunikojnë Ministrit të brendshëm dhe kuesturës së provincës ku ndodhen arsenalet në të cilat mbahen në depozitë <sup>(59)</sup>.

---

(59) Nen i shtuar nga gërma h) e paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

---

**14. Armë të papërshtatshme dhe ta pakataloguara.**

Nëse armët e zakonshme të qitjes dhe tytat e paraqitura tek Banka ose tek seksionet nuk e kalojnë provën e parashikuar nga neni 1, L. i 23 shkurtit 1960, nr. 186, ose rezultojnë të pakataloguara ose jo sipas llojeve të kataloguara ose nuk e kalojnë verifikimin e parashikuar nga neni 23, paragrafi 12-sexiesdecies, e dekret – ligjit të 6 korrikut 2012, n. 95, i konvertuar, me modifikime, nga ligji i 7 gushtit 2012, n. 135, lajmërohet, brenda tridhjetë ditëve, nën kujdesin e Bankës ose të seksionit, prodhuesi ose importuesi <sup>(60)</sup>.

Mbasi kalojnë tridhjetë ditë nga komunikimi i njoftimit të parashikuar në paragrafin e parë dhe prodhuesi nuk e ka urdhëruar tërheqjen e armëve ose importuesi nuk e ka kërkuar ridërgimin, me shpenzimet e tij, të vetë armëve në doganën që ka bërë nacionalizimin e tyre, për ridërgimin jashtë shtetit, armët konsiderohen të braktisura dhe dërgohen tek drejtorja kompetente e artilerisë që mund të urdhërojë kthimin në mbeturinë dhe tjetërsimin vijues.

Konsiderohen njëloj të braktisura armët e dërguara në doganë në bazë të paragrafit të mësipërm, për të cilat importuesi nuk ka kërkuar ridërgimin jashtë territorit doganor brenda njëzet ditëve nga komunikimi të interesuarit nga ana e vetë doganës.

Ridërgimi jashtë shtetit i armëve të papërshtatshme dhe të pakataloguara zbatohet për të shmangur ndalimet ekonomike dhe valutore në fushën e armëve dhe sjell lehtësim të të drejtave doganore të likuiduara në momentin e importimit dhe rimbursimin e atyre të paguara më parë, të përjashtuara në çdo rast kompensimet për shërbimet e bëra.

Dispozitat që përmban paragrafi i dytë, i tretë dhe i katërt janë të aplikueshme edhe për kthimin prodhuesve dhe importuesve të armëve për të cilët është kërkuar depozitimi ose paraqitja nga ana e Ministrisë së brendshme për katalogimin në bazë të nenit të mësipërm 7.

[Kundër gjykitimit negativ të Bankës kombëtare të provës për moskatalogim të një arme pranohet rekurs brenda tridhjetë ditësh pranë Ministrisë së brendshme] <sup>(61)</sup>.

---

(60) Paragraf i modifikuar në këtë mënyrë nga n. 1) i gërmës d) të paragrafit 1 të nenit 2, D. Lgs. i 29 shtatorit 2013, n. 121.

(61) Paragraf i shfuqizuar nga n. 2) i gërmës d) të paragrafit 1 të nenit 2, D. Lgs. i 29 shtatorit 2013, n. 121.

---

(koment jurisprudence)

**15. Importimi i përkohshëm i armëve të zakonshme të qitjes.**

Qytetarët italianë rezidentë jashtë shtetit ose me vendbanim jashtë shtetit për arsye pune, ose të huajt jo rezidentë në Itali, pranohen që të bëjnë import të përkohshëm armësh të zakonshme qitje, pa leje të parashikuar në nenin 31 të dekretit mbretëror të 18 qershorit 1931, n. 773, për qëllime sportive ose gjuetie, të pajisur me numrin e matrikullit, si edhe armë të zakonshme qitje për qëllime tregtie vetëm që t'i ekspozojnë gjatë panairëve, ekspozitave, ekspozimeve, ose qëllime vlerësimi dhe riparimi <sup>(62)</sup>.

Me dekret të Ministrit të brendshëm, në marrëveshje me Ministrat e punëve të jashtme, të financave, të bujqësisë dhe të pyjeve, të tregtisë me jashtë dhe për turizmin dhe shfaqjen, i cili duhet publikuar në Gazetën Zyrtare, përcaktohen modalitetet për futjen, zotërimin, mbajtjen dhe transportimin brenda Shtetit të armëve të importuara përkohësisht si edhe numri i tyre.

Për qëllimet e këtij ligji konsiderohet i përkohshëm importimi për një periudhë jo më shumë se nëntëdhjetë ditë. Mbasi kalon ky afat i interesuari është subjekt i detyrimeve të parashikuara në nenin e mëparshëm 12.

Kushdo që nuk respekton dispozitat e dekretit ministror të parashikuar në paragrafin e dytë dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit dhe me gjobë nga 4.000 euro deri në 30.000 euro <sup>(63)</sup>.

---

(62) Paragraf fillimisht i modifikuar nga numri 1) i gërmës i) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010, më pas i zëvendësuar kështu nga germa e) e paragrafit 1 të nenit 2, D. Lgs. i 29 shtatorit 2013, n. 121.

(63) Paragraf i modifikuar kështu fillimisht nga neni 113, paragrafi i katërt, L. i 24 nëntorit 1981, n. 689 dhe më pas nga numri 2) i gërmës i) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010. Për shkak të nenit 26 të kodit penal, masa e sanksionit nuk mund të jetë më e ulët se 50 euro.

---

**16. Eksportimi i armëve.**

Në operacionet që kanë lidhje me armët e zakonshme të qitjes të parashikuar në nenin e mëparshëm 2 të deklaruara për eksportimin, janë të detyrueshme kontrolli doganor dhe vërtetimi i policisë financiare.

Lëshimi i lejes së policisë, e veçantë, e shumëfishtë dhe globale, të bëra me përjashtim të parashikimeve të nenit 1, paragrafi 11, i ligjit të 9 korrikut 1990, n. 185, siç është modifikuar nga dekreti legjislativ i 22 qershorit 2012, nr. 105, për eksportimin e armëve të zakonshme të qitjes të çdolloj tipi i nënshtrohet aplikimit të dispozitës së nenit 11 të rregullores (CE) n. 258/2012 <sup>(64)</sup>.

Titullari i lejes së policisë duhet t'i paraqesë organit kompetent që e ka lëshuar lejen faturën e eksportimit, ose kopjen e saj të njëzuar me origjinalin ose të vërtetuar nga vetë organi kompetent <sup>(65)</sup>.

Kundërvajtësi i detyrimit të parashikuar në paragrafin e mëparshëm dënohet sipas normës së nenit 17 të Tekstit Unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773, dhe modifikimet pasuese.

Me dekret të Ministrit, për financat, në marrëveshje me Ministrin e brendshëm, i cili duhet publikuar në Gazetën Zyrtare, përcaktohen modalitetet për të siguruar daljen efektive nga territori i Shtetit të armëve të destinuar për eksportim, si edhe ato për të disiplinuar eksportin e përkohshëm, nga ana e personave me vendqëndrim në Itali, të armëve të zakonshme të qitjes për përdorim sportiv ose gjuetie, ose të armëve të zakonshme të qitjes për qëllime tregtare vetëm për qëllime ekspozuese gjatë panaireve, ekspozitave, ekspozive, ose për vlerësim dhe riparim <sup>(66)</sup>.

Me dekret të Ministrit të brendshëm, mbasi ka dëgjuar Ministrin për trashëgiminë kulturore, i cili duhet publikuar në Gazetën Zyrtare, përcaktohen modalitetet përkatëse për eksportimin e përkohshëm të armëve antike, artistike, të rralla ose sidoqoftë që kanë rëndësi historike për qëllime ekspozitash e shkëmbimesh kulturore.

---

(64) Paragraf i zëvendësuar kështu nga n. 1) i gërmës f) të paragrafit 1 të nenit 2, të D. Lgs. të 29 shtatorit 2013, n. 121.

(65) Paragraf i zëvendësuar kështu nga n. 2) i gërmës f) të paragrafit 1 të nenit 2, të D. Lgs. të 29 shtatorit 2013, n. 121.

(66) Paragraf i zëvendësuar kështu nga n. 3) i gërmës f) të paragrafit 1 të nenit 2, të D. Lgs. të 29 shtatorit 2013, n. 121.

---

**17.** *Ndalim për shitblerjen e armëve të zakonshme të qitjes të porositura me korrespondencë.*



Për personat me vendqëndrim në territorin e Shtetit nuk lejohet shitblerja e armëve të zakonshme të qitjes të porositura me korrespondencë, me përjashtim nëse blerësi është autorizuar që të ushtrojë aktivitete industriale ose tregtare në fushën e armëve, ose që ka marrë një leje të posaçme nga prefekti i provincës ku e ka vendqëndrimin. Çdo dërgesë ndërmarrja e interesuar duhet t'ia komunikojë zyrës së sigurisë publike, ose, në mungesë, komandës së karabinierëve të komunës ku e ka vendqëndrimin marrësi.

Shkelësit dënohen me burgim nga një deri në gjashtë muaj dhe me gjobë deri në 154 euro <sup>(67)</sup>.

---

(67) Masa e gjobës është rritur kështu nga neni 113, paragrafi i katërt, ligji i 24 nëntorit 1981, n. 689. Për shkak të nenit 24 të kodit penal, masa e sanksionit nuk mund të jetë më e ulët se 50 euro.

---

*(koment jurisprudence)*

### **18. Modalitete për transportin e armëve dhe eksplozivëve.**

Përveç rastit nëse është urdhëruar ndryshe nga autorizimi përkatës, transporti i armëve të parashikuara në nenet 1 dhe 2 ose pjesë të atyre duhet të bëhet vetëm me shërbime publike ose nga ndërmarrje transporti në zotërim të kërkesave të kërkuara nga dispozitat në fuqi legislative dhe rregulluese, ose nga subjekte vartës të ndërmarrjeve prodhuese ose tregtare të pajisur me autorizim specifik të kuestorit të provincës së vendqëndrimit, në zotërim të kërkesave të parashikuara nga neni i mëparshëm 9.

Përveç asaj që është përcaktuar në këtë fushë nga teksti unik i ligjeve për sigurinë publike të 18 qershorit 1931, nr. 773, dhe nga dekreti mbretëror i 6 majit 1940, n. 635, me modifikimet pasuese përkatëse, modalitetet për transportin, e armëve ose të pjesëve të tyre dhe të eksplozivëve të çdo lloji, si edhe për dërgimin, pritjen, marrjen dhe dorëzimin në shtëpi, përcaktohet me dekret të Ministrit të brendshëm, i cili duhet publikuar në Gazetën Zyrtare, në marrëveshje me Ministrat e mbrojtjes, të financave, të transporteve, të marinës tregtare dhe të postave e telekomunikacioneve, në kuadrin e kompetencave përkatëse.

Kushdo që nuk respekton dispozitat e paragrafit të parë ose ato të dekretit të Ministrit të parashikuar në paragrafin e mëparshëm dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në një vit dhe me gjobë nga 20 euro deri në 103 euro <sup>(68)</sup>.

Dispozitat e këtij neni nuk aplikohen tek fishekët e gjuetisë me saçme, mësimorë, të qitjes dhe për përdorim industrial dhe për pluhurat përkatëse të armëve të gjuetisë. Lëshimi për shitësat e librezave të njohjes të parashikuara nga neni 52 i rregullores së 6 majit 1940, n.

635, për vendin e dorëzimit të armëve në provincë lihet në kompetencë të kuestorit, mbas verifikimit të ekzistencës së kërkesave të parashikuara në nenin e mëparshëm 9.

---

(68) Masa e gjobës është rritur kështu nga neni 113, paragrafi i katërt, ligji i 24 nëntorit 1981, n. 689. Për shkak të nenit 24 të kodit penal, masa e sanksionit nuk mund të jetë më e ulët se 50 euro.

---

*(koment jurisprudence)*

### **19. Transporti i pjesëve të armëve.**

Detyrimi për njoftim i parashikuar përkatësisht nga nenet 28 dhe 34 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773, duhet të vërehet edhe për transportin e pjesëve të veçanta të armëve luftarake dhe të atyre të ngjashme me ato luftarake si edhe të tytave, skeletit, rrëshqitësit, trungut, tamburëve dhe të kandarëve të armëve të zakonshme <sup>(69)</sup>.

Nëse veprimi nuk përbën një vepër penale më të rëndë, kundërvajtësi dënohet me burgim jo më të ulët se një muaj dhe me gjobë nga 250 euro deri në 1.000 euro nëse bëhet fjalë për pjesë të armëve luftarake ose të lloji të ngjashëm me ato luftarakë; me burgim deri në tre muaj dhe me gjobë deri në 500 euro nëse bëhet fjalë për pjesë të armëve të zakonshme <sup>(70)</sup>.

Për qëllimet e këtij neni nuk duhen konsideruar pjesë të armës ato që janë ende në një gjendje gjysmë të përpunuar. Për gjysmë të përpunuar duhet kuptuar ajo pjesë e armës që, në mënyrë që të mund të montohet tek arma dhe të garantojë funksionimin e saj, ka nevojë për punime të mëtejshme mekanike. Nuk duhen konsideruar punime mekanike trajtimet sipërfaqësore të metaleve <sup>(71)</sup>.

---

(69) Paragraf i modifikuar kështu fillimisht nga numri 1) i gjermës I) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(70) Paragraf i modifikuar kështu fillimisht nga neni 113, paragrafi i katërt, L. i 24 nëntorit 1981, n. 689 dhe më pas nga numri 2) i gjermës I) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010. Për shkak të nenit 26 të kodit penal, masa e sanksionit nuk mund të jetë më e ulët se 50 euro.

(71) Paragrafi i shtuar nga numri 3) i gërmës 1) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

---

*(koment jurisprudence)*

**20. Ruajtja e armëve dhe e eksplozivëve. Denoncimi i vjedhjes, humbjes ose gjetjes.**

Ruajtja e armëve të parashikuara në nenet e mëparshme 1 dhe 2 dhe e eksplozivëve duhet të sigurohet me çdo lloj kujdesi në interes të sigurisë publike. Ai që ushtron profesionalisht aktivitet në fushën e armëve dhe të eksplozivëve ose është i autorizuar të mbledhë ose të koleksionojë armë duhet të zbatojë dhe të mbajë mbrojtje efikase kundër vjedhjes sipas modaliteteve të caktuara nga organi kompetent i sigurisë publike.

Kushdo që nuk i respekton normat e parashikuara në paragrafin e mëparshëm dënohet, nëse veprimi nuk përbën një veprë penale më të rëndë, me burgim nga një deri në tre muaj ose me gjobë deri në 516 euro <sup>(72)</sup>.

Për humbjen ose vjedhjen e armëve ose të pjesëve të tyre ose të eksplozivëve të çfarëdolloj natyre duhet të bëhet denoncim i menjëhershëm pranë zyrës lokale të sigurimit publik ose, nëse kjo mungon, në komandën më të afërt të karabinierëve.

Kundërvajtësi dënohet me gjobë deri në 516 euro <sup>(73)</sup>.

Kushdo që gjen një armë ose pjesë të saj duhet që të zbatojë menjëherë dorëzimin pranë zyrës lokale të sigurisë publike ose në rast mungese, pranë komandës më të afërt të karabinierëve të cilët lëshojnë një faturë të posaçme.

Kushdo që gjen eksplozivë të çfarëdolloj natyre ose mëson se ka depozita ose gjetje të eksplozivëve duhet t'ia japë lajmin menjëherë zyrës lokale të sigurisë publike ose, në mungesë, komandës më të afërt të karabinierëve.

Me përjashtim të aplikimit të sanksioneve të parashikuara nga dispozitat në fuqi në fushën e zotërimit dhe të mbajtjes së paligjshme të armëve ose të eksplozivëve të çfarëdolloj natyre, kundërvajtësi dënohet me burgim deri në gjashtë muaj dhe me gjobë deri në 206 euro <sup>(74)</sup>.

Me një ose më shumë dekrete të Ministrisë së Brendshme, të cilët duhen zbatuar brenda gjashtë muajsh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj dispozite përcaktohen modalitetet dhe afatet e ruajtjes së armëve dhe të pjesëve të parashikuara në paragrafin e parë në lidhje me numrin e armëve ose të pjesëve të armëve të zotëruara, duke parashikuar edhe sisteme të sigurimit elektronik ose të mbrojtjes pasive, si edhe modalitetet dhe afatet për të siguruar, edhe me modalitete telepatike, gjurmimin e të gjitha armëve, të pjesëve të tyre

dhe të municioneve, nëpërmjet futjes së mekanizmave të thjeshtësimit dhe të shkathtësimit të zotërimeve të parashikuara <sup>(75)</sup>.

---

(72) Masa e gjobës është rritur kështu nga neni 113, paragrafi i katërt, ligji i 24 nëntorit 1981, n. 689. Për shkak të nenit 26 të kodit penal, masa e sanksionit nuk mund të jetë më e ulët se 20 euro.

(73) Masa e gjobës është rritur kështu nga neni 113, paragrafi i katërt, ligji i 24 nëntorit 1981, n. 689. Për shkak të nenit 26 të kodit penal, masa e sanksionit nuk mund të jetë më e ulët se 20 euro. Sanksioni përjashtohet nga depenalizimi në bazë të nenit 34, paragrafi i parë, germa c), i ligjit të cituar të 24 nëntorit 1981, n. 689.

(74) Masa e gjobës është rritur kështu nga neni 113, paragrafi i katërt, ligji i 24 nëntorit 1981, n. 689. Për shkak të nenit 26 të kodit penal, masa e sanksionit nuk mund të jetë më e ulët se 20 euro. Sanksioni përjashtohet nga depenalizimi në bazë të nenit 32, paragrafi i dytë, i ligjit të cituar të 24 nëntorit 1981, n. 689.

(75) Paragraf i shtuar nga gërma m) e paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

---

*(komment jurisprudence)*

#### **20-bis. Mosruajtja e armëve.**

Kushdo që i dorëzon një minoreni nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, që nuk është në zotërim të lejes së organit kompetent, ose personave edhe pjesërisht të paaftë, narkomanëve ose personave të penguar në përdorim, një armë mes atyre të treguara në paragrafin e parë e të dytë të nenit 2, municione ose eksplozive të ndryshëm nga lojërat me zjarr, përveçse kur veprimi përbën një vepër penale të më të rëndë, me burgim deri në dy vjet.

Kushdo që lë pas dore të përdorë, në ruajtjen e armëve, municioneve dhe eksplozivëve të parashikuar në paragrafin e parë, masat e nevojshme për të penguar që ndonjë nga personat e treguar në të njëjtin paragraf 1 të arrijë t'i marrë në zotërim lehtësisht ato, dënohet me burgim deri në një vit dhe me gjobë deri në 1.032 euro.

Aplikohet dënimi me gjobë nga 154 euro deri në 516 euro kur veprimi për të cilin flitet në paragrafin e parë kryhet:

a. në vendet e përgatitura për qitje, gjithmonë nëse nuk bëhet fjalë për ushtrimin e lejuar të aktivitetit sportiv;

b. në vendet ku mund të zhvillohet aktiviteti i gjahut.

Kur veprimet e parashikuara në paragrafët e mëparshëm kanë të bëjnë me armët, municionet ose eksplozivët e treguar në nenin 1 ose armë klandestine, dënimi është burgimi nga një deri në tre vjet <sup>(76)</sup>.

---

(76) I shtuar nga neni 9, D.L. i 13 majit 1991, n. 152, në tekstin e modifikuar nga ligji përkatës i konvertimit.

---

*(koment jurisprudence)*

### **21. Përvetësim ose grabitje armësh.**

Kushdo që përvetëson nga destinacioni i parashikuar, grabit ose zotëron armët e parashikuara nga nenet 1 e 2 me qëllimin për të përmbysur rendin shtetëror ose për të vënë në rrezik jetën e personave ose sigurinë e kolektivitetit nëpërmjet kryerjes së atentateve ose sidoqoftë njërën prej veprave penale të parashikuara nga kreu I, titulli VI, i librit II të kodit penal ose nga nenet 284, 285, 286 dhe 306 të të njëjtit kod, dënohet me burg nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

---

*(koment jurisprudence)*

### **22. Qiradhënie dhe huapërdorje armësh <sup>(77)</sup>.**

Nuk lejohet qiradhënia ose huapërdorja e armëve të parashikuar nga nenet 1 dhe 2, përveçse kur bëhet fjalë për armë të përdorimit skenik, ose armë të destinuara për përdorim sportiv ose gjuetie, ose kur shoferi ose huadhënësi është i pajisur me autorizim për fabrikimin e armëve ose municioneve dhe kontrata bëhet për nevoja studimi, eksperimentimi, kolaudimi. Për armët e zjarrit për përdorim skenik kuptohen armët të cilave, me marifete të thjeshta teknike, u mbyllet pjesërisht tyta me qëllimin e vetëm që të ndalojë daljen e një predhe dhe përdorimi i tyre kontrollohet vazhdimisht nga armëtari që i ka në ngarkim. Armët e zjarrit për përdorim skenik i nënshtrohen, me shpenzim të të interesuarit, verifikimit të Bankës kombëtare të provës, që do t'i vërë një shënues të posaçëm <sup>(78)</sup>.

Dënohet me burg nga dy deri në tetë vjet dhe me gjobë nga 2.000 euro deri në 20.000 euro kushdo që jep ose merr me qira ose hua armë në shkelje të ndalimit të parashikuar nga paragrafi i mëparshëm <sup>(79)</sup>.

Dënimi dyfishohet nëse aktiviteti i qerasë ose i huasë së armëve rezulton i zakonshëm.

---

(77) Shiko, edhe, paragrafin 1 të nenit 6, të D. Lgs. i 29 shtatorit 2013, n. 121.

(78) Paragraf i modifikuar kështu fillimisht nga numri 1) i gërmës n) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010 dhe më pas nga germa g) e paragrafit 1 të nenit 2, të D. Lgs. i 29 shtatorit 2013, n. 121.

(79) Paragraf i modifikuar kështu fillimisht nga neni 113, paragrafi i katërt, L. i 24 nëntorit 1981, n. 689 dhe më pas nga numri 2) i gërmës n) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

---

*(koment jurisprudence)*

### **23. Armë klandestine.**

Konsiderohen klandestine:

1) armët e zakonshme të qitjes të pakataloguara në bazë të nenit të mëparshëm 7, ose që nuk i janë nënshtruar verifikimit të parashikuar nga neni 23, paragrafi 12-sexiesdecies, i dekret-ligjit të 6 korrikut 2012, n. 95, i konvertuar, me modifikime, nga ligji i 7 gushtit 2012, n. 135<sup>(80)</sup>;

2) armët e zakonshme dhe tytë pa numra, pa shenja dhe sigla të parashikuara në nenin 11.

Dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga 2.000 euro deri në 20.000 euro kushdo që fabrikon, fut në territorin e Shtetit, eksporton, tregton, nxjerr në shitje ose jep armë ose tyta klandestine <sup>(81)</sup>.

Kushdo që zotëron armë ose tyta klandestine dënohet me burgim nga një deri në gjashtë vjet dhe me gjobë nga 1.000 euro deri në 15.000 euro <sup>(82)</sup>.

Aplikohet dënimi i burgimit nga dy deri në tetë vjet dhe me gjobë nga 2.000 euro deri në 20.000 euro për këdo që mban në vend publik ose të hapur për publikun armë ose tyta klandestine. I njëjti dënim aplikohet gjithashtu për këdo që fshin, imiton ose ndërton numrat e katalogut ose të matrikullit dhe shenjat e tjera dalluese të parashikuara në nenin 11 <sup>(83)</sup>.

Me vendimin e dënimit urdhërohet revokimi i autorizimeve të policisë në fushën e armëve dhe konfiskimi i vetë armëve.

Nuk është i dënueshëm, në bazë të këtij neni, për mungesë të shenjave të identifikimit të caktuara për armët e zakonshme të qitjes, kushdo që kryen transportin për prezantimin e prototipit në Bankën kombëtare të provës për kryerjen e verifikimit të parashikuar nga neni 23, paragrafi 12-sexiesdecies, i dekret – ligjit të 6 korrikut 2012, nr. 95, i konvertuar, me modifikime, nga ligji i 7 gushtit 2012, n. 135, ose importimin në bazë të nenit 11 <sup>(84)</sup>.

(80) Numër i modifikuar kështu nga n. 1 i gjërës h) të paragrafit 1 të nenit 2, D. Lgs. i 29 shtatorit 2013, n. 121.

(81) Paragraf fillimisht i zëvendësuar nga neni 9, D. L. i 13 majit 1991, n. 152 dhe më pas i modifikuar kështu nga numri 1) i gjërës o) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(82) Paragraf fillimisht i zëvendësuar nga neni 9, D. L. i 13 majit 1991, n. 152 dhe më pas i modifikuar kështu nga numri 2) i gjërës o) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(83) Paragraf fillimisht i zëvendësuar nga neni 9, D. L. i 13 majit 1991, n. 152 dhe më pas i modifikuar kështu nga numri 3) i gjërës o) i paragrafit 1 të nenit 5, D. Lgs. i 26 tetorit 2010, n. 204, duke filluar nga 1 korriku 2011, në bazë të sa urdhërohet nga paragrafi 1 i nenit 8 të të njëjtit D. Lgs. n. 204/2010.

(84) Paragraf i zëvendësuar kështu nga n. 2 i gjërës h) të paragrafit 1 të nenit 2, D.Lgs. i 29 shtatorit 2013, n. 121.

#### **24. Ndalim fabrikimi eksplozivësh të panjohur.**

Kushdo fabrikon një produkt shpërthyes të panjohur ose modifikon ose ndryshon përbërjen e produkteve shpërthyes të njohura dhe klasifikuara sipas normës së nenit 53 te tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet dhe me gjobë nga 206 euro deri në 1.032 euro <sup>(85)</sup>.

Sanksioni i parashikuar në paragrafin e mëparshëm nuk aplikohet tek fabrikantët e produkteve shpërthyes titullarë të lejes së lëshuar nga Ministria e brendshme për aktivitetin kërkimor, studim dhe eksperimentim të kryer në stabilimentin e vet.

---

(85) Masa e gjobës është rritur kështu nga neni 113, paragrafi i katërt, ligji i 24 nëntorit 1981, n. 689.

---

*(koment jurisprudence)*

**25. Regjistër i operacioneve të përditshme.**

Kushdo që, për të ushtruar aktivitetin e tij të punës, e bën të zakonshme përdorimin e eksplozivëve të çfarëdolloj tipi duhet të mbajë regjistrin e operacioneve të përditshme të parashikuar nga paragrafi i parë i nenit 55 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773.

Dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet dhe me gjobë nga 206 euro deri në 2.065 <sup>(86)</sup> euro ai që nuk respekton detyrimin e parashikuar nga paragrafi i mëparshëm.

Dënohen me burgim nga njëzet ditë deri në tre muaj dhe me gjobë deri në 103 euro <sup>(87)</sup> personat e detyruar që të mbajnë regjistrin e sipërpërmendur të cilët refuzojnë pa të drejtë që t'ua tregojnë vetë regjistrin oficerëve dhe agjentëve të sigurisë publike që ia kërkojnë.

---

(86) Masa e gjobës është rritur kështu nga neni 113, paragrafi i katërt, ligji i 24 nëntorit 1981, n. 689.

(87) Masa e gjobës është rritur kështu nga neni 113, paragrafi i katërt, ligji i 24 nëntorit 1981, n. 689. Për shkak të nenit 26 të kodit penal, masa e sanksionit nuk mund të jetë më e ulët se 20 euro.

---

*(koment jurisprudence)*

**26. Kufizime në zotërim pa denoncim të municioneve.**

Është subjekt i detyrimit për të bërë denoncim, i përcaktuar nga neni 38 i tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773, ai që në pronësi të armëve rregullisht të denoncuara, zotëron municione për armë të zakonshme qitje më shumë se pajisjet me 1000 fishekë me saçme për pushkë gjuetie <sup>(88)</sup>.

---

(88) Gjykata Kushtetuese, me urdhrin e 17 – 30 tetorit 1996, nr. 368 (Gazeta Zyrtare e 6 nëntorit 1996, n. 45, Seria speciale), ka deklaruar pathemelësinë e qartë të çështjes së legjitimitetit kushtetues të nenit 26, të ngritur në lidhje me nenin 3, të Kushtetutës.



---

**27. Kërkesa subjektive për autorizime në fushën e eksplozivëve.**

Lëshimi i lejes së parashikuar në nenet 46 e 47 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, numër 773, i nënshtrohet verifikimit të kërkesave të parashikuar në nenin e mëparshëm 9.

---

**28. Përgjegjësi në përdorimin e eksplozivëve.**

Titullarët e lejes së depozitimit për konsum të përhershëm, të përkohshëm ose të përditshëm të eksplozivëve të çdo tipi, të përshtatur për çfarëdolloj përdorimi, të parashikuar në nenet 46 e 47 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773, dhe 100 e 101 të dekretit mbretëror të 6 majit 1940, nr. 635, dhe modifikimet vijuese, duhet të ndjekin personalisht ose vetëm nëpërmjet personave që i përfaqësojnë sipas normës së nenit 8 të tekstit unik të përmendur aktivitetet dhe operacionet e shfrytëzimit dhe të përdorimit të vetë eksplozivëve.

Kushdo që nuk i respekton dispozitat e këtij paragrafi dënohet me burgim nga tre muaj deri në një vit dhe me gjobë nga 103 deri në 1.032 euro <sup>(89)</sup>.

---

(89) Masa e gjobës është rritur kështu nga neni 113, paragrafi i katërt, ligji i 24 nëntorit 1981, n. 689.

---

*(koment jurisprudence)*

**29. Përvetësim ose grabitje eksplozivësh.**

Kushdo që përvetëson nga destinacioni i parashikuar, grabit ose zotëron eksplozivë të çdo lloji me qëllimin për të përmbysur rendin shtetëror ose për të vënë në rrezik jetën e personave ose sigurinë e kolektivitetit nëpërmjet kryerjes së atentateve ose sidoqoftë njëjërën prej veprave penale të parashikuara nga kreu I, titulli VI, i librit II të kodit penal ose nga nenet 284, 285, 286 dhe 306 të të njëjtit kod, dënohet me burg nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

---

**30. Armë, municione dhe eksplozivë të Forcave të armatosura dhe të Trupave të Shtetit.**

Autorizimet e parashikuara nga teksti unik i ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773, nga dekreti mbretëror i 6 majit 1940, nr. 635, dhe nga ky ligj, si edhe zbatimet e parashikuara në nenet 28, paragrafi i tretë, dhe nga 34 i të përmendurit tekst unik të ligjeve të sigurisë publike nuk kërkohen për armët, ose pjesë të tyre, municione dhe eksplozivë që i përkasin Forcave të armatosura dhe trupave të armatosura të Shtetit dhe për personelin e Forcave të armatosura dhe të Trupave të armatosur të Shtetit të përdorura në ushtrimin e funksioneve dhe në detyra të tjera të institucionit.

Me dekret të Ministrit të mbrojtjes, që duhet publikuar në Gazetën Zyrtare, në marrëveshje me Ministrin e brendshëm, do të specifikohen dokumentet e shoqërimit të nevojshme për transportin e armëve ose pjesë të tyre, të municioneve ose të eksplozivëve që mos të zbatohet direkt nga Forcat e armatosura ose nga Trupat e armatosura të Shtetit.

---

*(koment jurisprudence)*

### **31. Mbikëqyrje e aktiviteteve të qitjes në shenjë.**

Pa ndryshuar dispozitat e Qitjes në shenjë kombëtare që përmban kodi i organizimit ushtarak dhe në tekstin unik të dispozitave rregulluese në fushën e organizimit ushtarak drejtuesit dhe instruktorët e seksioneve të Bashkimit të qitjes në shenjë kombëtare duhet të pajisen me leje të posaçme nga prefekti, që duhet të lëshohet mbas verifikimit të aftësisë teknike dhe të kërkesave të parashikuara në nenin e mëparshëm 9<sup>(90)</sup> (91).

Aftësia teknike pretendohet për ata që ushtrojnë aktivitetin e tyre në gjirin e seksioneve të qitjes në shenjë në hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Kryetarët e seksioneve të qitjes në shenjë janë të detyruar që të mbajnë vazhdimin të përditësuar:

a) listën e të regjistruarve me gjeneralitetet përkatëse;

b) inventarin e armëve të pajisjeve me përshkrimin përkatës për numrin e matrikullit, llojin, kalibrin, fabrikën dhe kombësinë, duke iu referuar titujve që legjitimojnë prejardhjen, për qëllimet e paragrafit të fundit të nenit 38 të tekstit unik të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, nr. 773.

c) regjistrin e ngarkim shkarkimit për municionet, me të dhënat e emrave të përdoruesve;

d) një regjistër për frekuencat ku duhet të shënohen çdo ditë gjeneralitetet e atyre që ushtrojnë qitjen, me të dhënën e armëve të përdorura nga secili si edhe oraret e fillimit dhe të mbarimit të ushtrimeve të veçanta.

Aktet e parashikuara në këtë paragraf duhet të paraqiten mbas çdo kërkesë të oficerëve ose agjentëve të sigurisë publike, të cilët vendosin aty datën dhe nënshkrimin sa herë që procedojnë me shqyrtimin e tyre.

Kryetarët e seksioneve të qitjes në shenjë janë përgjegjës të respektimit të dispozitave të paragrafit të parë të nenit 20 të këtij ligji.

Vërtetimi i kartës së njohjes të parashikuar nga neni 76 i dekretit mbretëror të 6 majit 1940, n. 635, i njihet organit kompetent provincial të sigurisë publike që procedon sipas kompetencave të përcaktuara nga nenet 42 e 44 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike, mbas verifikimit të kërkesave subjektive të urdhëruara për lëshimin e lejeve të mbajtjes së armëve.

Me përjashtim të rastit kur veprimi përbën një vepër penale më të rëndë, shkelësi i detyrimeve të parashikuara në këtë ne, dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet ose me gjobë nga 206 euro deri në 1.032 euro <sup>(92)</sup>.

(90) Paragraf i modifikuar në këtë mënyrë, duke nisur nga 9 tetori 2010, në bazë të dispozitës së kombinuar të paragrafit 1 të nenit 2129 dhe të nenit 2272, D. Lgs. të 15 marsit 2010, n. 66.

(91) Shiko, edhe, nenin 163, D. Lgs. të 31 marsit 1998, n. 112.

(92) Masa e gjobës është rritur kështu nga neni 113, paragrafi i katërt, ligji i 24 nëntorit 1981, n. 689.

### **32. Mbikëqyrje e armëve dhe municioneve të mbledhura në muze.**

Përveç normativës mbi armët që janë pajime të Forcave të armatosura ose të Trupave të armatosura të Shtetit dhe duke mbetur e pandryshuar ajo që është përcaktuar në ligjin e datës 1 qershor 1931, n. 1089, për sendet me interes historik ose artistik, drejtuesit e muzeve të Shtetit, të enteve të tjera publike ose pjesëtarë të enteve morale, të cilëve u është besuar ruajtja dhe mirëmbajtja e koleksioneve të armëve luftarake ose të llojit të ngjashëm me ato të luftës ose pjesë të tyre, të municioneve luftarake, të koleksioneve të armëve të zakonshme të qitjes, të koleksioneve të armëve artistike, të rralla ose antike duhet, brenda tre muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të hartojnë inventarin e materialeve të ruajtura në regjistër të posaçëm në bazë të *nenit 16, paragrafi i parë, i dekretit mbretëror të 6 majit 1940, n. 635.*

Personat e përshkruar në paragrafin e parë janë të detyruar gjithashtu të kujdesen për përditësimin e përpiktë të inventarit, duke ia komunikuar menjëherë ndryshimet kuestorit.

Për hartimin e inventarit dhe të ndryshimeve të vërehen formalitetet e parashikuara nga neni 31, paragrafi i tretë, germa b).

Inventari dhe përditësimet përkatëse duhet t'i tregohen oficerëve dhe agjentëve të sigurisë publike sa herë t'i kërkojnë të cilët vendosin datën dhe firmën sa herë që procedojnë me shqyrtimin e tyre.

Përveç rastit kur veprimi përbën një vepër penale më të rëndë, shkelësi i detyrimeve të përshkruar në këtë nen dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet ose me gjobë nga 206 euro deri në 1.032 euro <sup>(93)</sup>.

Për muzetë e treguar në këtë nen nuk aplikohen dispozitat e parashikuara në paragrafin e parë të nenit 28 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773.

Mbetet e pandryshuar dispozita e paragrafit të fundit të nenit 37 të dekretit mbretëror të 6 majit 1940, n. 635, leja e Ministrisë të brendshëm nuk parashkruhet për dhënien e relikeve ose armëve nga ana e vetë muzeve.

Armët antike dhe artistike që u jepen organit kompetent të sigurisë publike ose drejtorive të artilerisë nuk mund të shkatërrohen pa lejen paraprake të një eksperti të emëruar nga drejtuesi i galerive kompetent për zonën.

Armët e njohura me interes historik dhe artistik do të destinohen për grumbullimet publike të treguara nga drejtoria e galerive kompetent për zonën.

Kjo disiplinë nuk aplikohet për armët që janë pajisje të Trupave të armatosura të Shtetit eventualisht të destinuara për shkatërrim.

---

(93) Masa e gjobës është rritur kështu nga neni 113, paragrafi i katërt, ligji i 24 nëntorit 1981, n. 689.

---

### **33. Ankande publike.**

1. Është e ndaluar shitja, në ankandet publike, e armëve të treguara në nenet 1 dhe 2.

2. Përveç rastit kur veprimi përbën një vepër penale më të rëndë, shkelësi i detyrimit të parashikuar në paragrafin 1 dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet dhe me gjobë nga 103 euro deri në 516 euro <sup>(94) (95)</sup>.

---

(94) Është zëvendësuar kështu nga neni 10-bis, D. L. i 13 majit 1991, n. 152, në tekstin e modifikuar nga ligji përkatës i konvertimit.

(95) Gjykata Kushtetuese, me urdhrin e 11-21 korrikut 2000, nr. 326 (Gazeta Zyrtare e 26 korriku 2000, n. 31, Seria speciale), ka deklaruar pathemelësinë e qartë të çështjes së legjitimitetit kushtetues të nenit 33, të zëvendësuar nga neni 10-bis i dekret ligjit të 13 majit 1991, n. 152, i konvertuar, me modifikime, në ligjin e 12 korrikut 1991, nr. 203, të ngritur në lidhje me nenin 3, paragrafi i parë, dhe 24, paragrafi i parë, të Kushtetutës.

---

*(koment jurisprudence)*

### **34. Sanksione penale.**

Dënimet e përcaktuara nga kodi penal dhe nga teksti unik i ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773, dhe modifikimet pasuese, për kundërvajtjet ndaj normave mbi eksplozivët janë trefishuar.

Në çdo rast burgimi nuk mund të jetë më i ulët se tre muaj <sup>(96)</sup>.

---

(96) Shiko, edhe, nenin 11, L. i 21 dhjetorit 1999, n. 526.

---

*(koment jurisprudence)*

### **35. Gjykim direkt.**

Për veprat penale të parashikuara nga ky ligj, procedohet në çdo rast me gjykim direkt me përjashtim të rastit kur janë të nevojshme hetime speciale. Për veprat penale të bashkuara procedohet, si rregull, mbas ndarjes së gjykimeve.

---

*(koment jurisprudence)*

### **36. Ndrejqje (të veprimeve juridike).**

Zotëruesit e armëve të zakonshme të qitjes që, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk kanë marrë masa të denoncojnë në bazë të nenit 38 të tekstit unik të ligjeve për sigurinë publike të 18 qershorit 1931, n. 773, të njëjtat armë, nuk janë të dënueshëm, në bazë të dispozitave në fuqi, nëse veprojnë në përputhje me detyrimin e denoncimit brenda afatit

prej gjashtëdhjetë ditësh nga data e mësipërme, gjithnjë nëse denoncimi bëhet para verifikimit të veprës penale.

Nuk dënohen gjithashtu ato që, brenda të njëjtit afat prej gjashtëdhjetë ditësh dhe para verifikimit të veprës penale, i dorëzojnë armët ose pjesë të tyre, municionet, eksplozivët dhe aparatet e tjera vdekjeprurëse të zotëruara në mënyrë të paligjshme të parashikuar në nenin 1 të ligjit të 2 tetorit 1967, n. 895, të modifikuar nga neni 9 i ligjit të 14 tetorit 1974, n. 497 <sup>(97)</sup>, as ata që brenda këtij afati kujdesen për detyrimin e denoncimit të parashikuar në nenin 13 të dekret-ligjit të 6 korrikut 1974, n. 258, të konvertuar me modifikime në ligjin e 14 gushtit 1974, n. 393.

Së fundi, nuk janë të dënueshëm ato që zotërojnë, në bazë të denoncimit, të prezantuar sipas nenit 38 të tekstit unik të ligjit të sigurisë publike, dhe i pranuar nga organet kompetente, armë luftarake ose të llojit të ngjashëm me ato luftarake të blera pa vend si armë të zakonshme para hyrjes në fuqi të këtij ligji, gjithnjë që të kujdesen për zbatimet e përcaktuara brenda gjashtëdhjetë ditësh nga publikimi i katalogut të parashikuar në nenin e mësipërm 7.

---

(97) Përmban norma kundër kriminalitetit.

---

*(koment jurisprudence)*

### **37. Dispozita kalimtare dhe përfundimtare.**

Deri në publikimin e katalogut kombëtar për armët e zakonshme të qitjes të parashikuar nga neni 7, pranohet prodhimi, importimi dhe eksportimi, me kusht që ushtruesit e këtij aktiviteti të jenë të pajisur me lejet e caktuara nga organi kompetent i sigurimit publik dhe që çdo armë të jetë e shënuar me numër matrikulli.

Lejohen gjithashtu edhe mbas publikimit të katalogut kombëtar të parashikuar nga neni 7, eksportimi dhe tregtia e armëve të zakonshme të qitjes të pakataloguara, të prodhuara ose të importuara më parë, mjaft që të jetë të regjistruara me numrat përkatës të matrikullit, në bazë të nenit 35 të tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773

---

**38.** Dispozitat e parashikuara në nenin 5 të këtij ligji për lojërat aplikohen mbasi ka kaluar një vit nga dita e hyrjes në fuqi të vetë ligjit.

---

**39.** Brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi të këtij ligji organi kompetent i sigurisë publike duhet të procedojë me një rishikim të jashtëzakonshëm të autorizimeve të privatëve për mbledhjen e armëve luftarake ose të atyre të ngjashme me ato luftarake ose pjesë të tyre ose municione luftarake, të parashikuara nga neni 28 i tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773.

Në rastin e revokimit të lejes, armët, brenda tridhjetë ditësh nga masa përkatëse, mund t'u jepen enteve publike si edhe subjekteve të pajisur me autorizim për fabrikimin e armëve luftarake ose të atyre të ngjashme me ato luftarake ose të municioneve luftarake, enteve dhe personave me vendqëndrim jashtë shtetit.

---

**40.** Për gjithçka që nuk parashikohet nga ky ligj vazhdojnë të aplikohen dispozitat e tekstit unik të ligjeve të sigurisë publike të 18 qershorit 1931, n. 773, të dekretit mbretëror të 6 majit 1940, nr. 635, me modifikimet pasuese përkatëse, si edhe me dispozitat e tjera legjislative në fuqi dhe rregulluese në fushën e armëve dhe eksplozivëve.

Asgjë nuk ka ndryshuar nga dispozitat e ligjit të datës 14 tetor 1974, nr. 497 <sup>(98)</sup>.

---

(98) Përmban norma kundër kriminalitetit.

---

**107967/2200 = 50 pgs**